

*Divizioni për Sigurim të Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim*



**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosova - Republic of Kosovo*

*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Arsimit dhe Shkencës**  
*Ministarstva za Obrazovanje i Nauku*  
*Ministry of Education and Science*

***KORNIZA E VLERËSIMIT  
TË NXËNËSVE TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR TË KOSOVËS***

*Prishtinë, 2020*

**Divizioni për Sigurim të Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*  
*Ministria e Arsimit dhe Shkencës*  
*Ministarstva za Obrazovanje i Nauku*  
*Ministry of Education and Science*

# **KORNIZA E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË KOSOVËS**

**Prishtinë, 2020**

**Kontribuesit që morën pjesë në hartimin e Kornizës së vlerësimit të nxënësve të arsimit parauniversitar të Kosovës**

**Grupi punues:**

Fehmi Hysenaj, Agim Bërdynaj, Mustafë Kadriu, Fatmir Elezi, Nizafete Bardhi-Kutllovci, Mirlinda Dehari Zeka, Feime Llapashtica, Selim Mehmeti, Besim Avdimetaj, Nazmi Zogaj, Musa Nikçi, Fahrije Latifi Ratkoceri, Milazim Avdyli, Linda Ukimeraj

**Grupi redaktues:**

Mirlinda Dehari Zeka, Nizafete Bardhi-Kutllovci, Feime Llapashtica, Lulavere Behluli, Selim Mehmeti, Musa Nikçi

**Falënderojmë për kontributin dhe mbështetjen gjatë këtij procesi:**

Projekti KESIP (Projekti për përmirësimin e sistemit të arsimit në Kosovë) i financuar nga Banka Botërore  
Kompania e Binjakëzimit CITO (Instituti për Matjet Arsimore, Holandë) me ekspertin Dr. Sanneke J. Schouwstra.

**Redaktori gjuhësor:**

Fazli Gajraku

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>TABELA E PËRMBAJTJES.....</b>	<b>3</b>
<b>LISTA E SHKURTESAVE.....</b>	<b>6</b>
<b>1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>7</b>
<b>2. HYRJE.....</b>	<b>10</b>
<b>KAPITULLI I.....</b>	<b>12</b>
<b>STRUKTURA E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE KORNIZA E KURRIKULËS .....</b>	<b>12</b>
1.1. Tiparet kryesore strukturore të sistemit shkollor të Kosovës .....	12
1.1.1. Struktura e arsimit.....	12
1.1.2. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja.....	15
1.1.3. Kurrikula .....	17
1.2. Ndarja e përgjegjësiave.....	18
1.2.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës .....	18
1.2.2. Komunat.....	19
1.2.3. Institucionet arsimore/shkollore.....	20
1.3. Ndryshimet e fundit ose ndryshimet e propozuara .....	20
1.4. Dokumentet relevante .....	21
<b>KAPITULLI II.....</b>	<b>23</b>
<b>KORNIZA E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE E KOSOVËS .....</b>	<b>23</b>
2.1. Qasja e përgjithshme e KKKVN-së .....	23
2.2. Vlerësimi i jashtëm i nxënësve në kontekstin e Kosovës .....	25
2.3. Qasja ndaj vlerësimit të nxënësve .....	27
2.4. Iniciativat dhe zbatimi i Kornizës së Vlerësimit .....	28
2.5. Dokumentet relevante .....	28
<b>KAPITULLI III - VLERËSIMI I NXËNËSVE.....</b>	<b>29</b>
3.1. Karakteristikat e përgjithshme të vlerësimit të nxënësve.....	30
3.1.1. Korniza legjislative e vlerësimit të nxënësve .....	30
3.1.2. Qëllimet dhe parimet e vlerësimit të nxënësve .....	31
3.1.3. Llojet e vlerësimit .....	33
3.2. Procedurat e vlerësimit të nxënësve.....	33
3.2.1. Vlerësimi i brendshëm .....	33
3.2.2. Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë procesit të mësimit (Vlerësimi formativ).....	34
3.2.3. Vlerësimi i vazhdueshëm në fund të çdo teme mësimore, njësie tematike ose periudhe mësimore (Vlerësimi përmbledhës) .....	35
3.2.4. Vlerësimi përfundimtar .....	36

3.2.5. Vlerësimi i shkollës kryesore .....	36
3.2.6. Udhëzimet e Kornizës për Vlerësimin e brendshëm të nxënësve .....	36
3.2.7. Vlerësimi i jashtëm .....	37
3.2.8. Provimet për vlerësimin e nxënësve .....	38
3.2.9. Sfidat .....	39
3.2.10. Udhëzimet e Kornizës për Vlerësimin e jashtëm të nxënësve .....	39
3.3. Kapaciteti i vlerësimit të nxënësve .....	40
3.3.1. Lloji i vlerësuesve .....	40
3.3.2. Ndërtimi i kapaciteteve .....	40
3.4. Raportimi dhe përdorimi i gjetjeve të vlerësimit të nxënësve.....	41
3.5. Zhvillimet e ardhshme në Vlerësimin kombëtar të nxënësve .....	41
3.5.1. Vlerësimi i nxënësve .....	41
3.5.2. Formësimi i së ardhmes .....	43
3.6. Dokumentet relevante .....	44
<b>KAPITULLI IV – ASPEKTE TË VLERËSIMIT TË MËSIMDHËNËSVE NË NDËRLIDHJE ME VLERËSIMIN E NXËNËSVE .....</b>	<b>45</b>
4.1. Kuadri i mësimdhënësve dhe vlerësimi i performancës së tyre .....	45
4.2. Aspekte të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve.....	46
4.3. Roli i mësimdhënësve në vlerësimin e nxënësve .....	47
4.4. Ndërtimi i kapaciteteve të mësimdhënësve për vlerësimin e nxënësve .....	48
4.5. Përdorimi i rezultateve të vlerësimit të nxënësve në punën me mësimdhënës .....	48
4.6. Dokumentet relevante .....	49
<b>KAPITULLI V – ASPEKTE TË VLERËSIMIT TË SHKOLLËS NË NDËRLIDHJE ME VLERËSIMIN E NXËNËSVE .....</b>	<b>51</b>
5.1. Sistemi i vlerësimit të performancës së institucionit arsimor/shkollës .....	51
5.2. Aspekte të vlerësimit të performancës së shkollës në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve ....	51
5.3. Roli i shkollës në vlerësimin e nxënësve dhe në sigurimin e cilësisë së vlerësimit të nxënësve52	
5.4. Drejtimit e ardhshme - për rolin e vlerësimit të nxënësve në vlerësimin e shkollës .....	53
5.4.1. Ndërtimi i kapaciteteve për vlerësimin e shkollës në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve .....	54
5.4.2. Përdorimi i rezultateve të vlerësimit të nxënësve për Vlerësim formativ të performancës së shkollës .....	55
5.5. Dokumentet relevante .....	56
<b>KAPITULLI VI - VLERËSIMI I SISTEMIT DHE ROLI I VLERËSIMIT TË NXËNËSVE .58</b>	
6.1. Karakteristikat e përgjithshme të vlerësimit në Arsimit parauniversitar.....	58
6.1.1. Korniza ligjore .....	58

6.1.2. Roli i vlerësimit të nxënësve në vlerësimin e sistemit .....	59
6.1.3. Baza e të dhënave të lidhura me vlerësimin e sistemit.....	59
6.1.4. Mekanizmat dhe kompetencat e vlerësimit të sistemit.....	60
6.2. Aspektet e vlerësimit të sistemit .....	61
6.3. Ndërtimi i kapaciteteve për vlerësimin e sistemit .....	62
6.4. Procedurat dhe instrumentet për vlerësimin e sistemit .....	62
6.5. Përdorimi i rezultateve të vlerësimit për hartimin e politikave .....	63
6.6. Dokumentet relevante .....	64

## **LISTA E SHKURTESAVE**

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DSCSVL	Divizioni për Sigurim të Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim
ISCED	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit i miratuar nga UNESCO në Konferencën e Përgjithshme në sesionin e saj të 29-të në Nëntor 1997 e ndryshuar me kalimin e kohës
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit i Kosovës
KKK	Korniza e Kurrikulës së Kosovës
KKKVN	Korniza Kombëtare e Kosovës për Vlerësimin e Nxënësve
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve

## **1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Korniza e Vlerësimit të Nxënësve të Arsimit Parauniversitar të Kosovës synon të prezantojë një përshkrim koherent dhe gjithëpërfshirës për mënyrën se si është i organizuar dhe i integruar Vlerësimi i brendshëm, Vlerësimi i jashtëm dhe Vlerësimi ndërkombëtar për nxënës të këtij niveli në Kosovë. Ky botim mund të shërbejë për arritjen e njohurive të bazuara në të nxënit dhe rezultatet e të nxënit, për të përvijuar, më tutje, edhe me udhëzime për drejtimet e vlerësimit të nxënësve, gjithherë duke iu referuar dokumenteve kurrikulare, legjislacionit në fuqi, si dhe trendeve të vlerësimit të nxënësve. Të dhënat empirike për rezultatet e të nxënit dhe të përparimit të nxënësve, të paraqitura në këtë publikim, janë një burim për të vënë pah pikat e forta dhe të dobëta të arsimit dhe për të ndihmuar të qartësohet rruga për përmirësimin e të nxënit.

Procesi i hartimit të Kornizës ka nisur në vitin 2018, kur është formuar dhe ka filluar të punojë grupi punues i përfaqësuar nga të gjitha palët e interesuara për procesin e vlerësimit të nxënësve në Kosovë. Grupit punues për hartimin e kësaj kornize i ka ofruar mbështetje Kompania e binjakëzimit CITO (Instituti për Matjen e Arsimit nga Holanda), që ishte e kontraktuar nga Projekti: Përmirësimi i Sistemit të Arsimit në Kosovë (KESIP), me përkrahje të Bankës Botërore dhe i menaxhuar nga MASH.

Në **Kapitullin I** paraqiten shkurtimisht të dhënat themelore për strukturë e sistemit arsimor në Kosovë, pasi që vlerësimi i nxënësve funksionon brenda sistemit arsimor. Në këtë kapitull përshkruhet struktura arsimore dhe jepen të dhënat zyrtare për numrin e shkollave, numrin e mësimdhënësve dhe numrin e nxënësve në sistemin tonë arsimor. Gjithashtu, jepet një përmbledhje për kurrikulën – e bazuar në kompetenca dhe në ndarje të përgjegjësive ndërmjet niveleve, si: Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, komunave, si dhe institucioneve arsimore të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Kapitulli përmbillet me paraqitjen e ndryshimeve të fundit që i përkasin strukturës së Arsimit Parauniversitar, si dhe fushës së reformës kurrikulare.

Në **Kapitullin II** paraqitet qasja ndaj Kornizës së Vlerësimit të Nxënësve në rrethanat e arsimit në Kosovë. Paraqiten zhvillimet kryesore që e përkufizojnë këtë kornizë në fushën e Arsimit parauniversitar dhe të vlerësimit të nxënësve në Kosovë. Duke iu referuar këtij kapitulli, Korniza ofron një pasqyrë koherente për veçoritë e vlerësimit të nxënësve, për procedurat e vlerësimit të nxënësve, për kapacitetet e vlerësimit të nxënësve dhe për përdorimin e rezultateve të fituara nga vlerësimi i nxënësve. Korniza do të ofrojë ndihmesë në procesin e përmirësimit të arsimit, duke e bërë të njohur procesin dhe qëllimin e vlerësimit të nxënësve, si dhe përdorimin e rezultateve të vlerësimit. Kapitulli përmbillet me dhënien e udhëzimeve për qasjen ndaj vlerësimit të nxënësve, duke treguar edhe për rrjedhën e zbatimit të Kornizës së Vlerësimit të Nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve në Arsimin parauniversitar të Kosovës, përshkruhet në **Kapitullin III**. Kapitulli fillon me paraqitjen e veçorive të përgjithshme të vlerësimit të nxënësve. Pasi jepet informacion për



kornizën legislative të vlerësimit të nxënësve në Kosovë, përshkruhen qëllimet dhe parimet e vlerësimit të nxënësve, si dhe llojet e vlerësimit. Paraqitet edhe dallimi midis Vlerësimit të brendshëm dhe Vlerësimit të jashtëm në sistemin arsimor të Kosovës. Përshkruhen procedurat aktuale për Vlerësimin e brendshëm (të vijueshëm) gjatë gjithë vitit shkollor, më pas - procedurat për vlerësimin përfundimtar - në fund të vitit shkollor, si dhe - për vlerësimin e shkallëve kryesore - në fund të secilës shkallë kurrikulare. Pas vlerësimeve të jashtme, në fund të klasës së 5-të, të 9-të dhe të 12-të, janë paraqitur edhe aspektet sfiduese me të cilat përballet procesi i vlerësimit në Kosovë. Para se të prezantohet raporti dhe përdorimi i rezultateve të vlerësimit, përmbajtja e tekstit na shpie drejt njohurisë për vlerësuesit e ndryshëm dhe procedurat për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve. Kapitulli përmbillet duke prezantuar një aspekt vrojtimi për zhvillimet e ardhshme në fushën e vlerësimit. Pra, vlerësimi i nxënësve, si rrjedhojë, po ecën kah një lloj vlerësimi që është i bazuar në kompetenca dhe kah një perspektivë e zhvillimit të normave të bazuara në dëshmi. Në një të ardhme jo fort të largët, një zhvendosje që çon kah një vlerësim i kombinuar – vlerësimi i sistemit dhe vlerësimi formues, mund të jetë shumë i frytshëm për arsimin në Kosovë.

Mësimdhënësit janë vlerësuesit kryesorë të nxënësve në institucionet shkollore, prandaj duhet parë ndërlidhjen e sistemit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve në Kosovë me vlerësimin e nxënësve. **Kapitulli IV** jep shkurtimisht njohuri për stafin mësimor dhe për vlerësimin e performancës së tyre, si dhe aspekte të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve në raport me vlerësimin e nxënësve. Në këtë kapitull, në pika të shkurtra, flitet për rolin e mësimdhënësve në procesin e vlerësimit të nxënësve, për ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve për të bërë vlerësimin e nxënësve dhe për përdorimin e rezultateve të vlerësimit të nxënësve në punën e mësimdhënies.

Vlerësimi i nxënësve zhvillohet brenda shkollës dhe luan një rol të caktuar në vlerësimin e shkollës. Prandaj, **Kapitulli V** përshkruan shkurtimisht sistemin e vlerësimit të performancës së shkollës dhe aspektet e vlerësimit të shkollës - të ndërlidhura me vlerësimin e nxënësve. Performanca e nxënësve është një nga fushat e vlerësimit të performancës së shkollës, pasi reflekton ndikimin e shkollës për të përmbushur misionin e saj kryesor. Gjithashtu, flitet edhe për rolin e shkollës për vlerësimin e nxënësve dhe për sigurimin e cilësisë së vlerësimit të nxënësve. Kapitulli përfundon me parashikimin e disa drejtimeve të ardhshme, duke përligjur diskutimin për rolin që ka vlerësimi i nxënësve për vlerësimin e shkollës.

Vlerësimi i nxënësve ka një rol të rëndësishëm dhe të veçantë për vlerësimin e sistemit arsimor në tërësi. Prandaj, në **Kapitullin VI** theksohet roli që ka vlerësimi i nxënësve për të bërë vlerësimin e sistemit. Në këtë kapitull, fillimisht jepen karakteristikat e përgjithshme të vlerësimit të sistemit, si dhe mekanizmat dhe kompetencat për vlerësimin e sistemit të arsimit. Më pas, kapitulli është përqendruar te aspektet e vlerësimit të sistemit, ndërtimi i kapaciteteve për të vlerësuar sistemin, procedurat dhe instrumentet e të vlerësuarit të sistemit, iniciativat dhe zbatimi i tyre. Në këtë kapitull përmenden rezultatet e vlerësimit kombëtar të nxënësve dhe, po ashtu, vëmendje e veçantë i kushtohet rezultatit të

vlerësimit ndërkombëtar në të cilin Kosova ka marrë pjesë (PISA) dhe vlerësimeve ndërkombëtare në të cilat planifikon të marrë pjesë në të ardhmen e afërt (TIMMS, PIRLS). Hulumtimet krahasuese ndërkombëtare kryesisht shërbejnë për informimin e sistemeve kombëtare të arsimit.

Kapitulli përmbyllet me një pasqyrë orientuese për përdorimin e rezultateve të vlerësimit dhe për hartimin e politikave.

Në fund të secilit kapitull, janë dhënë si referencë dokumentet përkatëse të cilave burime iu është referuar teksti, që dalin si pika orientimi, me qëllim që të bëhet i mundshëm një lexim sa më inter-referencial, i cili më pastaj do ta nxiste edhe më shumë dëshirën për hulumtime të tjera të teksteve e dokumenteve nga lexuesit që dëshirojnë më shumë informata dhe njohuri për këtë fushë.

## **2. HYRJE**

Ky dokument jep një përmbledhje koherente të vlerësimit të nxënësve të Arsimit parauniversitar në Kosovë. Qëllimi kryesor i vlerësimit të nxënësve është të mbështesë dhe të përmirësojë procesin e të nxënësve. Vlerësimi i nxënësve siguron informacione për rezultatet e të nxënësve dhe procesit të të nxënësve dhe se si mund të përmirësohet procesi i të nxënësve dhe mësimdhënies. Korniza e Vlerësimit të Nxënësve të Arsimit Parauniversitar synon të përshkruajë dhe të ofrojë udhëzime e drejtime në një mënyrë gjithëpërfshirëse sesi, organizimi dhe integrimi i Vlerësimit të brendshëm, Vlerësimit të jashtëm dhe Vlerësimit ndërkombëtar të nxënësve në Arsimin parauniversitar, mundëson gjykime të bazuara për procesin mësimor dhe rezultatet e nxënësve, si dhe masat për përmirësim dhe avancim.

Vlerësimi i nxënësve, siç përshkruhet në këtë kornizë, është i lidhur ngushtë me rezultatet e të nxënësve, shkathtësitë dhe kompetencat, që përcaktohen në dokumentet e kurrikulës. Kurrikula përshkruan gjithashtu qëllimet e përgjithshme, parimet dhe llojet e vlerësimit, për të siguruar lidhjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit të vlerësimit të nxënësve. Kurrikula dhe Korniza inkurajojnë përdorimin e drejtpeshuar të qasjeve të ndryshme të vlerësimit për monitorimin dhe vlerësimin sistematik të nxënësve, duke vijuar kah vlerësimi i bazuar në kompetenca.

Rezultatet e vlerësimit të nxënësve përdoren për të marrë vendime të informuara në lidhje me secilin nxënës, por, gjithashtu, mund të luajnë një rol në vlerësimin dhe në monitorimin e arsimit në nivele të tjera, pra vlerësimin e shkollës, vlerësimin e programeve arsimore ose vlerësimin e sistemit arsimor në tërësi. Informatat që merren nga vlerësimet dhe arritjet e nxënësve mund të përdoren për ngritjen e cilësisë, të barazisë dhe të efikasitetit të arsimit në shkollë. Në Kornizë, përshkruhet roli i vlerësimit të nxënësve në secilin nivel të sistemit arsimor dhe po ashtu procedurat e vlerësimit, kapacitetet për vlerësim, për raportimin dhe për shfrytëzimi e gjetjeve. Përmes shfrytëzimit të rezultateve të vlerësimit të nxënësve, veprimet e nivelit shkollor dhe të sistemit mund të orientohen dhe përqendrohen më mirë në përmirësimin e arsimit dhe llogaridhënies.

Për të marrë vendime të bazuara, vlerësimet duhet të jenë të një cilësie të mirë. Të gjitha vlerësimet duhet të jenë të drejta, transparente, të sigurta dhe të vlefshme. Prandaj, cilësia dhe vlefshmëria e provimeve janë shqetësimet kryesore të Kornizës. Në kuadër të Kornizës, vlerësohen kriteret për cilësinë e vlerësimeve dhe vështirësitë që ndikojnë në cilësinë e vlerësimit, por, gjithashtu, formulohen qëllime realiste dhe afate reale kohore për përmirësim.

Korniza e Vlerësimit të Nxënësve të Arsimit Parauniversitar e Kosovës promovon përdorimin e të dhënave empirike dhe ndihmon kalimin e vendimmarrjes së bazuar në dëshmi. Vendimmarrja e bazuar në dëshmi kërkon më shumë dëshmi dhe informata në lidhje me rezultatet dhe procesin e të nxënësve të nxënësve. Për më tepër, tendenca e arsimit në Kosovë për një autonomi më të madhe shkollore rrit nevojën për të monitoruar mënyrën se si po e bëjnë shkollat këtë. Të dhënat empirike të rezultateve të të nxënësve të nxënësve dhe të arritjeve të tyre, ofrojnë mundësinë për të reflektuar për pikat e dobëta dhe të forta të arsimit dhe tregojnë rrugën për përmirësim e tij.

Për shkak se vlerësimi i nxënësve funksionon dhe zhvillohet brenda sistemit shkollor, **në Kapitullin I** përshkruhen shkurtimisht veçoritë kryesore të sistemit shkollor. **Në Kapitullin II**, përshkruhet konteksti dhe qasja kosovare ndaj Kornizës së Vlerësimit të Nxënësve, për shkak se qëllimi kryesor i vlerësimit është përmirësimi i të nxënësve të nxënësve; nxënësit dhe vlerësimi i tyre janë në qendër të kornizës së vlerësimit.

**Në Kapitullin III**, përshkruhen tiparet e përgjithshme të vlerësimit të nxënësve, siç janë qëllimet dhe parimet e vlerësimit në Arsimin parauniversitar të Kosovës. Këtu përshkruhen llojet e ndryshme të

vlerësimit në Arsimin parauniversitar në Kosovë. Për secilin lloj të vlerësimit përshkruhet periudha e zbatimit, vlerësuesit, qëllimet kryesore të vlerësimit dhe se si dokumentohen rezultatet e vlerësimit.

Vlerësimi i nxënësve zhvillohet brenda shkollës dhe mësimdhënësit janë vlerësues të rëndësishëm, prandaj **Kapitulli IV** përshkruan rolin e mësimdhënësve për vlerësimin e nxënësve dhe për ngritjen e kapaciteteve të tyre për vlerësim. **Kapitulli V** përqendrohet te roli i shkollës për vlerësimin e nxënësve dhe sigurimin e cilësisë së vlerësimit të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve luan një rol të rëndësishëm dhe të veçantë për vlerësimin e sistemit arsimor në tërësi. Për këtë arsye, në **Kapitullin VI** vlerësimi i sistemit dhe roli i vlerësimit të nxënësve diskutohet me theks të veçantë më rastin e pjesëmarrjes në vlerësimet ndërkombëtare të nxënësve.

Ky dokument është një hap i parë në procesin e ngritjes së kapaciteteve për vlerësimin e nxënësve dhe monitorimin e rezultateve arsimore në Kosovë. Korniza e Vlerësimit synon të arrijë një pajtueshmëri dhe konsensus të përbashkët mes palëve të interesuara lidhur me qëllimet, standardet dhe kriteret për vlerësimin e rezultateve të të nxënësve, të shkathtësive dhe të kompetencave të nxënësve në Kosovë.

## **KAPITULLI I**

### **STRUKTURA E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE KORNIZA E KURRIKULËS**

Vlerësimi i nxënësve ka funksionin dhe qëllimin e tij për të cilin është krijuar dhe funksionon brenda sistemit arsimor. Në këtë kapitull jepen të dhënat themelore për sistemin arsimor, si: strukturën e sistemit të arsimit, numrin e shkollave, llojet e shkollave, numrin e fëmijëve/nxënësve, ndryshimet e fundit në kurrikulë, si dhe ndarjen e përgjegjësiive në sistemin arsimor. Korniza Kurrikulare e vitit 2011, e rishikuar dhe e aprovuar në vitin 2016, është dokument bazë për rregullimin e Arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës. Ky Dokument përcakton parimet themelore të Arsimit parauniversitar, kompetencat kryesore që duhet të zhvillohen dhe të arrihen nga të gjithë nxënësit, fushat kurrikulare, lëndët, plani dhe metodat e vlerësimit.

#### **1.1. Tiparet kryesore strukturore të sistemit shkollor të Kosovës**

##### **1.1.1. Struktura e arsimit**

Sistemi arsimor i Kosovës përbëhet nga Arsimi parashkollor, Arsimi fillor, Arsimi i mesëm i ulët, Arsimi i mesëm i lartë dhe Arsimi terciar. Ky sistem arsimor është në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (Tabela 0-1).

Arsimimi parashkollor (ISCED 0) përfshin fëmijët e moshës zero deri në ata të moshës pesëvjeçare (0-5). Arsimi fillor (ISCED 1) zgjat pesë vjet, duke filluar nga klasa 1 deri te klasa 5 (mosha 6-10). Arsimi i mesëm i ulët (ISCED 2) zgjat katër vjet, nga klasa 6 deri në klasën 9 (mosha 11-14-vjeçare). Në Arsimin e mesëm të lartë (ISCED 3), nxënësit mund të vijojnë Arsimin e mesëm të përgjithshëm (Gjimnazin) ose Arsimin profesional - për tre vjet, në klasën 10-12. Pas përfundimit të Arsimit të mesëm, nxënësit mund të shkojnë në Arsimin terciar ose të fillojnë të jenë pjesë e tregut të punës.

Nëpërmjet këtyre tri niveleve formale të arsimit, nxënësit përgatiten për të mësuar gjatë gjithë jetës apo të përgatiten për tregun e punës. Mundësitë që u ofrohen nxënësve për të arritur kualifikimet në nivele të ndryshme të Arsimit parauniversitar, të bazuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, janë paraqitur në Tabelën 0-1. Krahasuar me Kornizën e Kualifikimeve, Korniza e Kurrikulës u referohet katër niveleve formale të arsimit dhe pesë niveleve të kualifikimeve.

Tabela 1. Nivelet formale të Arsimit parauniversitar në Kosovë


Nivelet sipas ISCED <sup>1</sup>		Nivelet formale të Arsimit parauniversitar në Kosovë <sup>2</sup>	Mosha
		Arsimi i të rriturve / Mësimi gjatë gjithë jetës në shkallë të gjerë (Formal dhe Joformal)	23/24+
<b>ISCED 6</b>		Arsimi pasuniversitar	23/24+
<b>ISCED 5</b>		Arsimi universitar	
<b>ISCED 4</b>	Niveli 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi pas shkollës së mesme (jo-universitar)	18 +
<b>ISCED 3</b>	Niveli 4 Korniza Kombëtare e Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Gjimnazi (Klasa X-XII) Shkolla profesionale (Klasa X-XII)	Matura 15-17
	Niveli 3 Korniza Kombëtare e Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Shkolla profesionale (Klasa X-XI)	
<b>ISCED 2</b>		Arsimi i mesëm i ulët (Klasa VI-IX) Klasa përgatitore	11-14
<b>ISCED 1</b>		Arsimi fillor (Klasa I-V)	6-10
<b>ISCED 0</b>		Klasa përgatitore	5-6
		Arsimi parashkollor	lindja- 5

Në Kosovë është i detyrueshëm Arsimi fillor dhe Arsimi i mesëm i ulët. Në fund të çdo niveli të arsimit, MASH organizon Vlerësimin e jashtëm (Tabela 1). Pas Arsimit të mesëm të ulët, nxënësit mund të vijojnë shkollimin në gjimnaze ose në shkollë profesionale. Pas përfundimit të gjimnazit, nxënësit i nënshtrohen Provimit të Maturës. Me Ligjin për Provimin e Maturës Shtetërore (2016): (i) të gjithë nxënësit/kandidatët e gjimnazeve, të cilët me sukses e kanë përfunduar vitin e fundit, pajisen me diplomë dhe i nënshtrohen Provimit të Maturës shtetërore; (ii) të gjithë nxënësit/kandidatët, të cilët kanë kryer me sukses Provimin përfundimtar të Arsimit profesional, pajisen me diplomë. Nxënësit që dëshirojnë regjistrimin në IAL, i nënshtrohen Provimit të Maturës shtetërore.

<sup>1</sup>International Standard Classification of Education.

<sup>2</sup>Tri pjesët e fundit nuk janë pjesë të Arsimit parauniversitar.

Tabela 2. Struktura e përgjithshme e sistemit arsimor në Kosovë



Në Kosovë, Arsimi parauniversitar zhvillohet në institucionet publike dhe private. Pjesë e sistemit të arsimit publik në Kosovë janë 43 institucione Parashkollore, 942 Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, 125 Shkolla të mesme të larta (Tabela 0-2). Në kuadër të sistemit të arsimit në Kosovë, përfshihen edhe gjashtë qendra burimore.

Në Arsimin e mesëm të lartë, gjimnazet ndahen në drejtimet: Gjimnazi natyror, Gjimnazi shoqëroro-gjuhësor dhe Gjimnazi i specializuar (artistik, matematikor, gjuhësor, teknik, etj. (KKK, f. 32). Shkollat profesionale ndahen sipas profileve, si: të bujqësisë, të ekonomisë, të mjekësisë, të muzikës, të tregtisë, të teologjisë, të artit dhe të qendrave të kompetencës<sup>1</sup>.

**Tabela 3. Numri i institucioneve arsimore, numri i nxënësve dhe numri i mësuesve në institucionet arsimore publike të Kosovës në vitin 2019/2020, përfshirë nga niveli i Arsimit parashkollor deri te niveli i Arsimit të mesëm të lartë**

Përshkrimi	Arsimi i Detyrueshëm	Grupmosha	Numri i nxënësve	Numri i institucioneve publike	Mësuesit
<b>Arsimi parashkollor (ISCED 0)</b>	Jo	0-5	4164	44	553
<b>Arsimi parafillor (ISCED 1)</b>	Po <sup>2</sup>	5-6	21660	927	17426
<b>Arsimi fillor dhe Arsimi i mesëm i ulët (ISCED 2)</b>	Po	11-14	229338		
<b>Arsimi i mesëm i lartë (ISCED 3)</b>	Jo	15-17/18	74427	123	5255
<b>Total</b>			329589	1094	23234

### 1.1.2. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja në arsimin cilësor i referohet të drejtës të secilit fëmijë/nxënës dhe të ri për qasje dhe mundësi të barabarta për zhvillim maksimal të potencialeve të tij/të saj. Këto pritje reflektohen në parimet e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar. Sipas Raportit vjetor statistikor, me tregues arsimorë 2018/2019<sup>3</sup>, Shkalla Bruto e Regjistrimit (SHBR) në Arsimin fillor (Klasa 1-5) është - 100.3 %; në Arsimin e mesëm të ulët (klasa 6-9) - 90.5 %; në Arsimin fillor dhe në Arsimin e mesëm të ulët - 95.7 %; në Arsimin e mesëm të lartë (Klasa 10-12) - 86.82%; fëmijë që janë jashtë shkollës në arsimin e obliguar - 4.3%. Në vitin 2019/20, në Arsimin e mesëm të lartë, 53.2 % e nxënësve janë në Arsimin profesional.

<sup>1</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë & Agjencia për Statistikat e Kosovës (2016). Statistikat e Arsimit në Kosovë 2015/2016.

<sup>2</sup> Zbatohet sipas dispozitave kalimtare ligjore, sipas të cilave kërkohet të bëhet një vlerësim i kostos financiare. Përfshirja e fëmijëve në Klasën përgatitore është e lartë, mirëpo akoma kjo klasë nuk është e obligueshme për arsyet e cekura më lartë.

<sup>3</sup> <https://MASH.rks-gov.net/uploads/2019/12/raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2018-19.pdf>



Aktualisht, në Arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët, 51.5% e nxënësve janë meshkuj dhe 48.5% e nxënësve janë femra. Në Shkollën e mesme të lartë, në gjimnaze - 42.3% e nxënësve janë meshkuj, dhe 57.7% e nxënësve janë femra. Në Shkolla profesionale - 58.4% e nxënësve janë meshkuj dhe 41.6% e nxënësve janë femra. Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në Arsimin e detyrueshëm mbetet e ulët. Gjithashtu, është e ulët përfshirja e nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë në Arsimin parashkollor, Arsimin fillor dhe Arsimin e mesëm të lartë. Numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën nuk është monitoruar dhe nuk është raportuar për numrin e tyre si duhet, prandaj të dhënat për nxënësit që kanë braktisur shkollën nuk janë të sakta.

**Tabela 4. Të dhënat për nxënësit ashkali, romë dhe egjiptianë në vitin shkollor 2019/20**

Niveli	Ashkali			Romë			Egjiptianë			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Arsimi parashkollor/parafillor (mosha 0-<6)	100	85	185	64	53	117	35	32	67	199	170	369
Arsimi fillor/Arsimi i mesëm i ulët	1905	1771	3676	543	543	1086	549	499	1048	2997	2813	5810
Arsimi i mesëm i lartë	146	114	260	113	69	182	79	58	137	338	241	579
Gjithsej	2151	1970	4121	720	665	1385	663	589	1252	3534	3224	6758

**Tabela 5. Nxënësit në arsimin publik dhe privat sipas nivelit, në vitin akademik 2019/20**

Nxënësit në arsimin publik dhe privat sipas nivelit, në vitin akademik 2019/20									
Niveli	Publik			Privat			Total		
	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra	Total
<b>Arsimi parashkollor [mosha 0- &lt;5]</b>	2206	1958	4164	2718	2511	5229	4924	4469	9393
<b>Arsimi parashkollor [mosha 5- &lt;6]</b>	11244	10416	21660	1060	930	1990	12304	11346	23650
<b>Arsimi fillor/Arsimi i mesëm i ulët</b>	118085	111253	229338	2894	2358	5252	120979	113611	234590
<b>Arsimi i mesëm i lartë</b>	37852	36575	74427	1895	1585	3480	39747	38160	77907
<b>Total</b>	169387	160202	329589	8567	7384	15951	177954	167586	345540

Në raportet statistikore të paraqitura në baza vjetore, të cilat publikohen nga SMIA, rënia e numrit të nxënësve vërehet nga viti në vit. Kjo rënie paraqet trend statistikor tashmë të evidentuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe është një fakt për të cilin Korniza e Vlerësimit të Nxënësve parashikon që të merret për bazë në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

### 1.1.3. Kurrikula

Kurrikula është dokumenti bazë që rregullon Arsimin parauniversitar në Kosovë. Kurrikula është e bazuar në kompetenca, me synimin për të siguruar një bazë të shëndoshë të arsimit, për të mësuarit gjatë gjithë jetës, si dhe për të rritur cilësinë e arsimit dhe për të ndërtuar një shoqëri të dijes. Nga ky dokument bazë janë hartuar kurrikulat bërthamë për tri nivelet formale të Arsimit parauniversitar. Kurrikula synon rritjen e autonomisë dhe të llogaridhënies në nivel të shkollës sa i përket përcaktimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes arsimore.

Parimet e kurrikulës mbështesin zhvillimin dhe zbatimin e saj në Arsimin parauniversitar të Kosovës, duke përfshirë gjithëpërfshirjen, mësimin e integruar dhe koherent, (që mundëson një implementim autonom dhe fleksibil të kurrikulës në nivel të shkollës) përgjegjësinë dhe llogaridhënien, (që pasqyrojnë krijimin e një kulture për vlerësim të vazhdueshëm) si dhe zhvillimin e kompetencave kryesore.

Kompetencat kryesore përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënësve që duhet të arrijnë në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë tërësisë së sistemit arsimor parauniversitar. Kompetencat i referohen një grupi të ndërlidhur të njohurive, të shkathtësive dhe të qëndrimeve dhe vlerave që janë të zbatueshme dhe të transferueshme. “Ato u mundësojnë nxënësve të përballen me sfidat e epokës digjitale dhe me tregun e punës në bazë të njohurive në një botë të ndërvarur” (KKK, f. 16) Kompetencat kryesore në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës janë (KKK, f. 16-22):

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Korniza e Kurrikulës ka gjashtë shkallë kryesore, të cilat përfaqësojnë periudha kohore dhe karakteristika të përbashkëta në aspektin e zhvillimit të fëmijëve/nxënësve dhe të kërkesave të kurrikulës (Tabela 0 - 3). Brenda çdo niveli të Arsimit parauniversitar dallohen dy shkallët kryesore (Tabela 0 - 3). Fokusi i secilës shkallë është përshkruar në Kornizën e Kurrikulës, (f. 30 - 32).

**Tabela 5. Shkallët kryesore të kurrikulës**

Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit	Nivelet formale të Arsimit parauniversitar	Shkallët kryesore të kurrikulës
KSNA 3	Arsimi i mesëm i lartë Klasa XII	<b>Shkalla 6:</b> Konsolidim dhe specializim
	Arsimi i mesëm i lartë Klasa X-XI	<b>Shkalla 5:</b> Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional
KSNA 2	Arsimi i mesëm i lët Klasa VIII-IX	<b>Shkalla 4:</b> Përforcim dhe orientim
	Arsimi i mesëm i ulët Klasa VI-VII	<b>Shkalla 3:</b> Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim
KSNA 1	Arsimi fillor Klasa III-V	<b>Shkalla 2:</b> Përforcim dhe zhvillim
	Arsimi fillor Klasa I-II	<b>Shkalla 1</b>

KSNA 0	Klasa përgatitore	Përvetësim themelor
	Arsimi parashkollor	Shkalla Përgatitore Arsimimi në fëmijërinë e hershme

Në secilën shkallë, kompetencat zhvillohen nëpërmjet shtatë fushave kurrikulare. Këto fusha kurrikulare (të cilat përmbajnë një ose më shumë lëndë) janë bazë për organizimin e procesit arsimor dhe për përcaktimin e programeve mësimore. Fushat e kurrikulës janë:

1. Gjuhët dhe Komunikimi
2. Artet
3. Matematikë
4. Shkencat natyrore
5. Shoqëria dhe mjedisi
6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
7. Jeta dhe puna

Në kuadër të secilës shkallë të kurrikulës janë përshkruar pritshmëritë, (KKK, f. 33-37) të cilat pritet të arrihen nga nxënësit dhe të vlerësohen. Në dokumentet e Kurrikulave Bërthamë<sup>1</sup>, për secilën shkallë të kurrikulës janë dhënë rezultatet e kompetencave kryesore.

Korniza e Vlerësimit të Nxënësve e përcakton që më parë që Vlerësimi i brendshëm dhe Vlerësimi i jashtëm i nxënësve të bëhet mbi bazën e parimeve dhe të qëllimeve të kurrikulës, dhe që vlerësimet të jenë të bazuara në kompetenca. Për vlerësimin e nxënësve, duhet të merret për bazë procesi i zhvillimit dhe i zbatimit të kurrikulës dhe specifikat e klasave në të cilat bëhen vlerësimet. Gjithashtu, Korniza e Vlerësimit parashih që, në ndërlidhje me Kapitullin VI të këtij dokumenti, në kuadër të vlerësimeve, të këtë edhe Vlerësim të integruar apo Vlerësim të veçantë që ka në fokus vlerësimin e kurrikulës, me qëllim që të matet efektiviteti i saj dhe të kemi një përvijim për drejtimet në të ardhmen.

## 1.2. Ndarja e përgjegjësi

Ndarja e përgjegjësi të bartësve kryesorë në Arsimin parauniversitar në Kosovë është e përcaktuar me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës (2008)<sup>2</sup> dhe me Ligjin për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011)<sup>3</sup>. Këto dy ligje përshkruajnë detyrat dhe kompetencat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të komunave dhe të institucioneve arsimore.

### 1.2.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) është institucioni përgjegjës kryesor për sistemin e Arsimit parauniversitar, për vendosjen e standardeve dhe për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit. MASH promovon një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe jo diskriminues me mundësi të të nxënësve gjatë gjithë jetës. MASH është përgjegjës për hartimin e politikave dhe për zbatimin e

<sup>1</sup>Core curriculum for early childhood development (birth - 5 years); Core Curriculum for pre-primary grade and primary education; Core curriculum for lower secondary education; Core Curriculum for lower secondary education (Core Curriculum for gymnasias and Core Curriculum for vocational schools).

<sup>2</sup>Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-068 (2008), Prishtinë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L068\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L068_al.pdf)

<sup>3</sup>Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 04/L-032. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17/16 Shtator 2011, Prishtinë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

legjislacionit për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë arsimin e lartë, shkencën dhe inovacionin në Kosovë. MASH përcakton rezultatet e niveleve të ndryshme të Arsimit parauniversitar dhe u ofron kualifikime atyre që me sukses kanë përfunduar programet parauniversitare. MASH është përgjegjës për hartimin e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe të Programeve lëndore. MASH bën aprovimin e teksteve shkollore, miraton mjetet dhe materialet e tjera mësimore, për të siguruar standardet dhe cilësinë e materialeve të përdorura në institucionet arsimore, si dhe miraton programet e zhvillimit profesional dhe të përfshirjes së mësimdhënësve në trajnime, të financuara nga buxheti i Republikës së Kosovës. MASH përcakton kriteret dhe menaxhon një sistem të licencimit dhe të certifikimit të të gjithë mësimdhënësve.

MASH, gjithashtu, është përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e politikave arsimore, si dhe monitorimin e sistemit të arsimit, në të cilin është esenciale vendimmarrja e bazuar në të dhëna.

MASH publikon raporte të rregullta statistikore vjetore dhe raporte periodike të brendshme.

MASH ka për detyrë të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit në të gjitha nivelet dhe të lehtësojë zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor përmes mekanizmave për sigurim të cilësisë, siç është Inspektorati i Arsimit.

MASH përcakton rezultatet e niveleve të ndryshme të Arsimit parauniversitar dhe ofron kualifikime për ata që kanë përfunduar me sukses programet parauniversitare.

### **Inspektorati i Arsimit**

Inspektorati i Arsimit është organ ekzekutiv qendror, i cili është përgjegjës për sigurimin e cilësisë dhe është në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit të MASH-it dhe, sipas ligjit, kryen këto funksione:

- **Funksionin vlerësues** – vlerëson cilësinë e shërbimit të institucioneve arsimore;
- **Funksionin kontrollues** – kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve arsimore sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- **Funksionin këshillues** – këshillon drejtuesit dhe punonjësit e institucioneve arsimore;
- **Funksionin informues/raportues** – informon ministrin, DKA-të dhe institucionet arsimore për gjetjet gjatë inspektimit, si dhe i publikon ato në baza vjetore;
- **Funksioni mbështetës** – promovon praktikatat e suksesshme të institucioneve arsimore dhe zhvillimin e politikave arsimore.

Pra, roli i Inspektoratit të Arsimit në fushën e vlerësimit të nxënësve ndërlidhet me funksionet që ka në kuadër të detyrave dhe të përgjegjësisë.

#### **1.2.2. Komunat**

Përgjegjësitë dhe kompetencat e komunave rregullohen me Ligjin për Qeverisje Lokale, nr. 03 / L040, të datës 20 shkurt 2008, si dhe me Ligjin për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, të datës 03 / L-068, 21 maj 2008. Komunat janë përgjegjëse për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve arsimore dhe për sigurimin e mjedisi të shëndetshëm për nxënësit dhe stafin. Komunat regjistrojnë dhe pranojnë nxënës. Ato monitorojnë dhe u raportojnë për progresin e nxënësve - prindërve dhe autoriteteve të tjera. Ato mbikëqyrin dhe inspektojnë procesin arsimor në përputhje me udhëzimet e MASH-it. Komunat janë, gjithashtu, përgjegjëse për punësimin e mësimdhënësve dhe të personelit tjetër të shkollave, në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, të përzgjedhjes dhe të punësimit për të punësuarit publikë, si dhe përgjegjëse për përzgjedhjen e drejtorit dhe punësimin e mësuesve dhe personelit tjetër shkollor. Në përputhje me udhëzimet, me parimet dhe me standardet e MASH-it, komunat duhet të kujdesen për trajnimin e edukatorëve/e-ve dhe të stafit tjetër profesional. Komunat

menaxhojnë edhe buxhetin për institucionet arsimore, në të cilin përfshihen pagat, shërbimet dhe mallrat.

Përgjegjësi të tjera që u përkasin komunave, të cilat organizohen dhe mbikëqyren nga DKA, sipas përcaktimeve ligjore, janë edhe mbështetja e shkollave dhe e mësimdhënësve për zbatimin e reformës kurrikulare, si dhe për zbatimin e autonomisë së shkollës.

Për vlerësimin e nxënësve, komunat kanë rol mbështetës për shkollat - në Vlerësimin për shkallë kurrikulare, rol mbështetës - në organizimin e vlerësimeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare, si dhe rol mbështetës për mësimdhënës - në ngritjen e kapaciteteve në fushën e vlerësimit të nxënësve.

### **1.2.3. Institucionet arsimore/shkollore**

Përgjegjësitë e institucioneve arsimore, përkatësisht të organeve qeverisëse dhe profesionale të institucioneve arsimore/shkollave, janë të rregulluara me L-032, 2011 dhe akte të tjera ligjore, të cilat rregullojnë segmente të veçanta të funksionimit të institucioneve arsimore. Drejtori i një institucioni arsimor ka përgjegjësi ekzekutive për menaxhimin dhe për administrimin e përgjithshme të institucionit. Drejtori është përgjegjës për përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informimit të menaxhimit arsimor dhe mbajtjen e dokumenteve dhe të regjistrimeve, siç kërkohet nga komuna ose MASH. Drejtori, gjithashtu, ka detyra dhe përgjegjësi edhe për menaxhimin e stafit mësimdhënës dhe për zbatimin e kurrikulës në shkollë.

Për vlerësimin e nxënësve, shkollat kanë rolin kryesor për procesin e Vlerësimit të brendshëm të nxënësve, siç është përshkruar në dokumentet përkatëse, të cilat rregullojnë vlerësimin e nxënësve. Gjithashtu, roli i tyre është pjesëmarrja në vlerësimet Kombëtare dhe Ndërkombëtare, sipas procedurave dhe kriterëve që përcaktohen nga MASH. Shkollat në të ardhmen duhet të maksimalizojnë masat dhe veprimet për parandalimin e nxënësve për të kopjuar, duke përmbytur të drejtat e nxënësve për të marrë arsimim cilësor, që ofron mjedis mundësues dhe mësimdhënie cilësore.

### **1.3. Ndryshimet e fundit ose ndryshimet e propozuara**

Ndryshimet kryesore në sistemin e Arsimit parauniversitar në Kosovë janë përvijuar në politika arsimore, të cilat tashmë janë pjesë e dokumenteve strategjike, si: Plani Strategjik i Arsimit 2017-2021<sup>1</sup> dhe Strategjia për Sigurim të Cilësisë 2016-2020<sup>2</sup>.

Ndryshimet e fundit në strukturën e Arsimit parauniversitar dhe në reformën kurrikulare, përfshijnë:

- ndryshimet në strukturat për sigurimin e cilësisë; MASH, në përpjekje për sigurimin e cilësisë në Arsimin parauniversitar, ka emëruar Koordinatorët e Cilësisë në nivel shkolle, në nivel komune dhe në nivel qendror;
- ndryshimet në Inspektoratin e Arsimit - nga inspektorat mbikëqyrës, në inspektorat për sigurim të cilësisë;
- ndryshimet në organizimin e Shkallës së parë të kurrikulës, në të cilën Klasa Përgatitore, së bashku me klasat 1 dhe 2, përbëjnë Shkallën e parë;
- ndryshimet në vlerësimin e nxënësve për Shkallë kurrikulare; në Kapitullin III të kësaj Kornize, ofrohen informacione për qëllimet dhe arsyet e këtij vlerësimi.

---

<sup>1</sup>Më gjerësisht, shih: [https://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021\\_1.pdf](https://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf)

<sup>2</sup>Më gjerësisht, shih: <https://MASH.rks-gov.net/uploads/2016/12/qa-strategy-final-shqip.pdf>

Disa nga ndryshime të cilat po aplikohen në disa komuna, janë si në vijim:

- **Organizimi i shkollave sipas niveleve të arsimit** – është duke u bërë në komunën e Gjakovës, të Vushtrisë, të Shtimes, etj. Në disa shkolla urbane, Arsimi fillor (Klasa 1-5) është ndarë nga Arsimi i mesëm i ulët (Klasa 6-9). Synimi i MASH-it dhe i komunave është që në komunat dhe në shkollat në të cilat mund të aplikohet organizimi i mësimi sipas niveleve të arsimit - të bëhet, sepse është vlerësuar se është në interes të fëmijëve. Zvogëlimi i numrit të nxënësve në të gjitha shkollat përbën një sfidë dhe njëkohësisht një mundësi për riorganizimin e punës së shkollave sipas niveleve;
- **Organizimi i mësimi tërëditor** – është duke u pilotuar në disa shkolla të komunës së Prishtinës dhe të Shtimes. Synimi i MASH-it është që këtë organizim ta shtrijë në shkallë vendi, duke përdorur një strategji të qartë për krijim të kushteve;
- **Profilizimi i mësuesve në Arsimin fillor** – është duke u bërë në komunën e Gjilanit, në të cilën po pilotohet një praktikë sipas të cilës mësimitdhënësit klasorë të një shkolle profilizohen sipas lëndëve mësimore: Gjuhë shqipe, Matematikë apo lëndë të tjera. Një ndryshim të tillë, është duke planifikuar ta pilotojë edhe komuna e Prishtinës. Pas një shqyrtimi të praktikave nga këto komuna, pritet të vendoset për hapat e mëtejme.

Korniza e Vlerësimit të Nxënësve, në ndërlidhje me Kapitullin VI të këtij dokumenti, udhëzon që për ndryshimet që fillojnë në sistem, si në pjesën e përshkruar më sipër, të realizohen vlerësime të veçanta për të vlerësuar efektshmërinë e këtyre ndryshimeve në të nxënësve dhe përparimin e nxënësve dhe mundësitë e shtrirjes së ndryshimeve në kuadër të sistemit arsimor.

#### **1.4. Dokumentet relevante**

1. Ligji nr. 02 / L-67 Për Publikimin e Teksteve Shkollore, Burimeve Mësimore, Materialeve të Leximit dhe Dokumentacionit Pedagogjik.
2. Ligji nr. 03 / L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale (20 shkurt 2008). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
3. Ligji nr. 03 / L-068 Për Arsimin në Komunitatet e Republikës së Kosovës (21 maj 21, 2008). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
4. Ligji nr. 04 / L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (9 shtator 2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
5. Ligji nr. 04 / L-037 Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (9 shtator 2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2011/ e rishikuar 2016). Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.
7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2015). Raporti i Vlerësimit - Plani Strategjik i Arsimit i Kosovës (PSAK) 2011-2016.
8. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Plani Strategjik i Arsimit i Kosovës (PSAK) 2017-2021.
9. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Udhëzimi Administrativ nr. 16/2012 Për Furnizimin e Nxënësve me Libra të Lirë, Përdorimin dhe Mirëmbajtjen e Tyre.
10. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Udhërrëfytyes për Zbatimin e Kurrikulës 2016-2021.  
<https://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/03/udherrefyeyes-per-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf>

11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës.(2016). Kurrikulat Bërthamë të Rishikuara për (i) Arsimin Parafillor dhe Fillor, (ii) Arsimin e Mesëm të Ulët, dhe (iii) Arsimin e Mesëm të Lartë. Prishtinë. <http://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/02/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>
12. Ministria e Arsimit dhe Shkencës.(2018). Raporti Vjetor Statistikor me Tregues Arsimorë 2017 - 2018. MASH, Prishtinë. [https://MASH.rks-gov.net/uploads/2018/12/raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2017-18\\_1.pdf](https://MASH.rks-gov.net/uploads/2018/12/raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2017-18_1.pdf)

## KAPITULLI II

### KORNIZA E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE E KOSOVËS

#### 2.1. Qasja e përgjithshme e KKKVN-së

Vlerësimi është proces i rëndësishëm për të bërë të njohur indikatorët kryesorë të ngritjes së cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemi arsimor më funksional. Mbi bazën e këtij koncepti, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka hartuar politika për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit për të tri nivelet e Arsimit parauniversitar, si dhe ka caktuar akterët që i bën përgjegjës për zhvillimin dhe realizimin e vlerësimeve të arsimit nëpërmjet instrumenteve të vlerësimit, të cilët shprehin përmbushjen e kompetencave të përcaktuara në Kurrikulën e Arsimit parauniversitar.

Korniza e Kurrikulës, (2011, e rishikuar në vitin 2016)<sup>1</sup> është bazë e Kornizës së Vlerësimit të Nxënësve në Arsimin Parauniversitar të Kosovës. Nga ana tjetër, OECD ka zhvilluar një kornizë krahasuese për të ndihmuar vendet, që ato të vlerësojnë se si të zhvillojnë një kornizë koherente të vlerësimit. Udhëzimet e OECD-së (OECD, 2013)<sup>2</sup> ndihmuan për t'i dhënë një formë kësaj kornize. Konceptualizimi i OECD-së është më i përgjithshëm se sa Korniza e Vlerësimit të Nxënësve të Arsimit Parauniversitar të Kosovës. Udhëzimet e OECD-së janë përqendruar në të gjitha sistemet e vlerësimit, përfshirë vlerësimet për nxënësit, mësimdhënësit, shkollat dhe sistemin, ndërsa kjo kornizë përqendrohet në vlerësimin e nxënësve dhe në rolin e vlerësimit të nxënësve nëpërmjet vlerësimit të mësimdhënësve, të shkollës dhe të sistemit arsimor, siç është përshkruar në kapitujt IV, V dhe VI të këtij dokumenti.

Sipas OECD-së (OECD, 2013) është vërejtur rritja e rëndësisë së vlerësimeve dhe e përdorimit të tyre nga nxënësit, më këtë rast edhe në kontekstin e Kosovës. Lëvizja kah vendimmarrja, kërkon më shumë dëshmi dhe informacione për rezultatet e nxënësve dhe për të mësuarit. Për më tepër, prirja e arsimit në Kosovë - kah përpjekja për autonomi të shkollës, rrit nevojën për të monitoruar procesin se si po punojnë shkollat. Aktualisht, është rritur kërkesa për efektivitet, për barazi dhe për cilësi në arsimin e Kosovës.

Plani Strategjik i Arsimit i Kosovës, 2017-2021<sup>3</sup> i kushton më shumë vëmendje Vlerësimit të jashtëm të nxënësve se sa Plani i mëparshëm strategjik (PSAK 2011-2016). Në Planin Strategjik është konstatuar se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Departamentet e Arsimit Komunal tani kanë fituar përvojë në organizimin e testeve të ndryshme kombëtare. Megjithatë, vërehen disa sfida, që janë themelore, si: kredibiliteti i rezultateve të testimit në nivel kombëtar, cilësia e testeve shtetërore, kopjimi në shkollë dhe kopjimi i testeve, analiza e rezultateve kombëtare të testimit, përdorimi i tyre për të përmirësuar cilësinë, pjesëmarrjen në testet ndërkombëtare dhe përdorimi i rezultateve për politikë-bërje arsimore.

Objekti kryesor i Kornizës Kombëtare të Vlerësimit të Nxënësve është të përshkruajë se si është organizuar vlerësimi i nxënësve, që të mundësohen vlerësime të bazuara të të nxënësve dhe

---

<sup>1</sup>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Republika e Kosovës (2011/ e rishikuar 2016). Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës

<sup>2</sup><https://www.oecd.org/education/school/oecdreviewonevaluationandassessmentframeworksforimprovingschooloutcomescountrybackgroundreports.htm>

<sup>3</sup>Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2015). Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020. Prishtinë. <http://MASH.rks-gov.net/uploads/2016/12/qa-strategy-final-shqip.pdf>



që të ketë një fill udhëzues për të ardhmen a arsimit, duke iu referuar ndryshimeve kurrikulare dhe dokumenteve të tjera që e rregullojnë sistemin e vlerësimit të nxënësve. Gjithashtu, KKVN përshkruan se si është organizuar Vlerësimi i jashtëm kombëtar dhe ndërkombëtar, si është i lidhur me forma të tjera të vlerësimit, për të dhënë udhëzime për vlerësimin e nxënësve në të ardhmen, për rolin dhe qëllimet e përdorimit të vlerësimit të nxënësve.

Për çdo nivel të sistemit arsimor, përshkruhet roli i vlerësimit të nxënësve në praktikën aktuale të vlerësimit, paraqiten procedurat, kapacitetet, raportimi dhe përdorimi i rezultateve.

Të dhënat e Vlerësimit të jashtëm të nxënësve duhet të përdoren për përmirësimin e cilësisë së arsimit, prandaj vlerësimet duhet të jenë të një cilësie të mirë. Cilësia e vlerësimit dhe çështja e vlefshmërisë janë shqetësimet kryesore në Kornizë. Cilësia e Vlerësimeve të jashtme të nxënësve mund të vlerësohet përmes shtatë kritereve:<sup>1</sup>

- Specifikimi i qëllimit dhe i përdorimit të vlerësimit
- Cilësia e materialit të vlerësimit
- Përfaqësueshmëria e përmbajtjes së vlerësimit
- Besueshmëria e vlerësimit
- Vendosja e standardeve dhe/ose e normave dhe zbatimi i normave (përfshirë barazimin)
- Informacioni mbi administrimin dhe sigurinë
- Paanësia e vlerësimit

Më shumë detaje lidhur me kriteret për cilësinë e Vlerësimeve të jashtme, janë dhënë në Kapitullin III të këtij dokumenti.

Vlefshmëria e vlerësimeve ndërtohet gjatë gjithë procesit të zhvillimit të vlerësimit, por mund të rrezikohet për shkak të mangësive në procedura (të procesit të vlerësimit), duke filluar nga administrimi i vlerësimit e deri te procesi i vlerësimit të nxënësve (Tabela 1). Rishikimi i rreziqeve që ndodhin në secilën fazë, identifikon dhe sqaron përmirësimet e nevojshme në vetë vlerësimin dhe në procesin e vlerësimit.

**Tabela 6. Rreziqet potenciale për vlefshmërinë gjatë procesit të vlerësimit (Crooks&Kane, 1996)<sup>2</sup>**

Faza	Sfida
Administrata	Motivimi i ulët
	Ankthi i vlerësimit
	Kushtet e papërshtatshme të vlerësimit, siç janë kushtet jo të mira mjedisore ose udhëzimet e pamjaftueshme
	Nxënësi nuk mund ta komunikojë përgjigjen, për shembull - për shkak të aftësisë së kufizuar, udhëzimeve jo të qarta ose për shkak të përgjigjeve të hartuara dobët

<sup>1</sup> Sanders, P., van Dijk, P., Eggen, T., den Otter, D. & Veldkamp, B. (). RCEC Beoordelingssysteem voor de kwaliteit van studietoetsen en exams [Evaluation system for the quality of tests and exams]. Consulted at <http://www.rcec.nl/beoordelingssysteem/>.

<sup>2</sup>Crooks, T. J., & Kane, M. T. (1996). Threats to the valid use of assessments, *Assessment in Education: Principles, Policy & Practice*, 3 (3).

<b>Rezultati (Pikëzimi)</b>	Pikëzimi nuk arrin të zotërojë cilësitë e rëndësishme të performancës
	Theksim i panevojshëm të disa kritere, forma ose stile të përgjigjes
	Mungesa e konsistencës intravlerësuese dhe intervlerësuese
	Rezultat (pikëzim) tepër analitik
	Rezultat ( pikëzim) tepër holistik
<b>Grumbullimi</b>	Detyrat e agreguara shumë diverse
	Vlerë të papërshtatshme u janë dhënë aspekteve të ndryshme të performancës
<b>Përgjithësimi</b>	Kushtet e vlerësimit tepër të ndryshueshme
	Mospërputhje e kritereve të pikëzimit për detyra të ndryshme
	Shumë pak detyra
<b>Ekstrapolim</b>	Kushtet e vlerësimit shumë të kufizuara
	Pjesë të fushës së synuar nuk vlerësohen ose u jepet pak vlerë
<b>Vlerësimi</b>	Marrje e pamjaftueshme e informacionit për vlerësimin dhe kufizimet
	Interpretimi i ndërtuar në mënyrë joadekuate
	Interpretimi ose shpjegimi i njëanshëm
<b>Vendimi</b>	Standarde të papërshtatshme
	Vendime të dobëta pedagogjike
<b>Ndikimi</b>	Nuk janë arritur ndikime pozitive
	Del në pah ndikimi i madh negativ

Korniza e Vlerësimit udhëzon që përgatitja, organizimi dhe menaxhimi i çdo Vlerësimi të jashtëm të këtë pikë referimi rreziqet potenciale për vlefshmërinë gjatë procesit të vlerësimit, dhe të merren masa për sigurimin e cilësisë dhe të besueshmërisë së vlerësimeve dhe rezultateve të tyre.

## 2.2. Vlerësimi i jashtëm i nxënësve në kontekstin e Kosovës

Kosova ka kaluar një fazë të vështirë të zhvillimit të arsimit gjatë viteve '90-të, me një sistem paralel të arsimit. Menjëherë pas luftës, Kosova trashëgoi një situatë të rënduar ekonomike, sociale, që reflektonte në gjithë sistemin e arsimit, përfshirë edhe procesin e vlerësimit të nxënësve dhe të sistemit arsimor. Institucionet e formuara nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut filluan të kenë një zhvillim të hovshëm. Në kuadër të MASH-it u formua Njësia për Standarde dhe Vlerësim, (më vonë DSCSVL) me mbështetjen e programit të BB, që bëri pilotimin e një Vlerësimi të jashtëm me nxënësit e klasës së katërt (2002). Për herë të parë në vitin 2003 u organizua Testi i Arritshmërisë në fund të klasës së nëntë, përkatësisht në fund të nivelit të dytë të Arsimit parauniversitar, në të cilin u përcaktua qëllimi i këtij vlerësimi dhe përdorimi i rezultateve (ky vlerësim ishte orientues). Disa vjet me radhë, në fund të këtij vlerësimi, përgatitej raporti i cili prezantohej para zyrtarëve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Zyrave Rajonale të Arsimit<sup>1</sup>.

Në vitin 2006, për herë të parë, u organizua Provimi i Maturës, të cilit iu nënshtroan nxënësit e gjimnazeve që përfunduan këtë nivel të shkollimit. Një vit më vonë, më 2007, Provimi i Maturës u organizua për të gjithë nxënësit e Kosovës që përfundonin Arsimin e mesëm të lartë, domethënë nxënësit e Gjimnazeve dhe të Shkollave profesionale.

<sup>1</sup><https://MASH.rks-gov.net/divizioni-per-standarde-monitorim-dhe-vleresim>

Qëllimi i këtij vlerësimi ishte diplomimi dhe shfrytëzimi i rezultateve për konkurrim në universitet.

Tashmë këto dy nivele të vlerësimit janë pothuajse tradicionale dhe kanë një qëndrueshmëri, edhe pse në vijimësi punohet për përmirësimin e përmbajtjes dhe të formës, si dhe të administrimit të testeve. Në vitin 2008 është hartuar dhe në vitin 2016 është plotësuar Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore<sup>1</sup>, bazuar në këtë ligj, janë hartuar akte nënligjore<sup>2</sup> që e rregullojnë formën e organizimit të testit. Në Ligj përcaktohet funksioni i Këshillit të Maturës Shtetërore, i cili mbikëqyrë tërë procesin e vlerësimit të fundit të nivelit të tretë të Arsimit të mesëm të lartë. Në këtë proces përfshihen akterë nga Universiteti, Fakulteti i Edukimit, Drejtoritë komunale të arsimit dhe Drejtorë të shkollave (Gjimnaze dhe Shkolla profesionale). Janë bërë hulumtime nga Zyra e statistikave në MASH<sup>3</sup> për rezultatet e vlerësimeve nacionale (të dhëna statistikore) për nxënësit e klasës së 9-të dhe të klasës së 12-të, projekte të mbështetura nga UNICEF dhe GIZ.

Pas Shpalljes së Pavarësisë, Kosova aplikoi në OECD për Vlerësimet Ndërkombëtare, mbështetur nga organizatat ndërkombëtare, si BB dhe GIZ. Kështu, në vitin 2012, është bërë pilotimi për vlerësimin PISA dhe në vitin 2015, është realizuar faza kryesore e vlerësimit PISA<sup>4</sup>. Në vitin 2017, bëhet pilotimi dhe realizohet vlerësimi PISA 2018<sup>5</sup>. Në vitin 2018 bëhet pilotimi, ndërsa në vitin 2019 realizohet vlerësimi TIMSS dhe kanë filluar procedurat për vlerësimin PIRLS 2021.

MASH ka vlerësuar përparimin e arritjeve të nxënësve si në Vlerësimet nacionale ashtu edhe në Vlerësimet ndërkombëtare, prandaj, në këtë kontekst, ka emëruar Komisione për monitorimin e procesit të vlerësimit, si:

*Këshilli për Maturën Shtetërore* - Është një organ i veçantë vendimmarrës dhe mbikëqyrës për tërë procesin e Maturës shtetërore.

*Komisioni për Vlerësimin Ndërkombëtar PISA dhe TIMSS* - Organ i përkohshëm që ndihmon me dokumente, këshilla dhe raporte për përmirësimin e cilësisë në procesin e të nxënësve, bazuar në Raportin e PISA-s dhe TIMSS-it. Këto dy organe monitorojnë dhe vlerësojnë proceset e vlerësimeve të jashtme dhe i raportojnë Ministrin për organizimin dhe financimin e arsimit, si dhe për ecurinë e zbatimit të ndryshimit në fusha të veçanta përkatëse, duke u përqendruar në tema që shqetësojnë akterët e arsimit si dhe publikun.

Siç u përshkrua më lartë, në vitin 2015 Kosova për here të parë është bërë pjesë e vlerësimit ndërkombëtar PISA. Deri atëherë vlerësimet ishin bazuar në objektivat e programeve mësimore dhe në objektivat e dijes, edhe pse kishte pasur debate për Vlerësimeve të jashtme, të cilat i organizonte MASH, për formën dhe formatin e instrumenteve të vlerësimit; shpesh ishin gjetur justifikime për rezultate jo fort të kënaqshme. Pas vlerësimit PISA, rezultatet e të cilit ishin shokuese për akterët e institucioneve arsimore, por edhe për shoqërinë kosovare në përgjithësi, u bë një vetëdijësim për të aktivizuar të gjitha forcat për të ndryshuar segmente në sistemin e arsimit, siç është procesi i implementimit të kurrikulave

---

<sup>1</sup>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASH), 2016 Ligji nr. 05/L -018 për Provimin e Maturës Shtetërore.

<sup>2</sup><https://MASH.rks-gov.net/udhezimet-administrative>

<sup>3</sup><https://MASH.rks-gov.net/statistikat>

<sup>4</sup>Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). PISA – Raport për arritjet e nxënësve të Kosovës në PISA 2015. Divizioni për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim.

<sup>5</sup>Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). PISA – Raport për arritjet e nxënësve të Kosovës në PISA 2018. Divizioni për Sigurimin e Cilësisë, Vlerësime, Standarde, Monitorim dhe Licencim.

lëndore, ndryshimi i teksteve mësimore, hartimi i programeve të trajnimit të mësimdhënësve, si dhe emërimi i koordinatorëve të cilësisë në shkolla.

Pas vlerësimit ndërkombëtar PISA dhe pas publikimit të raportit, i cili e nxori Kosovën me bazë më të ulët të arritjeve, filluan debate të shumta nga akterë të ndryshëm të arsimit, prej atyre që janë bartës, mbështetës të arsimit, pjesëmarrës në sistemin e arsimit. Të gjithë kanë shqetësimin se si të përmirësohet sistemi i arsimit, me qëllim të rritjes së cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Viteve të fundit, synimet, objektivat dhe iniciativat janë përqendruar te përmirësimi i cilësisë dhe i efikasitetit të sistemit arsimor, përfshirë formimin e standardeve të arsimit, të krahasueshme me vendet e tjera anëtare të BE-së dhe modernizimin e përmirësimit të programeve mësimore dhe të metodave të mësimdhënies. Synohet të përmirësohet fleksibiliteti organizativ i institucioneve arsimore, duke rritur kështu autonominë e stafit mësimdhënës dhe duke u mundësuar nxënësve të zgjedhin deri në 20% të programeve mësimore sipas interesave të tyre. MASH mbështet rritjen e autonomisë së shkollave dhe të mësimdhënësve dhe në mënyrë të vazhdueshme kërkon uljen e ndërhyrjeve politike në vendimet profesionale në lidhje me arsimin, mirëpo nismat dhe projektionet e MASH-it vijojnë të sfidohen për shkak se legjislacioni aktual, që rregullon arsimin, nuk është i harmonizuar.

Është rritur nevoja për llogaridhënie dhe tashmë me ndryshimin e Ligjit për Inspektoriatin Arsimor<sup>1</sup> është bërë e mundur që shkolla të monitorohet më për së afërmi dhe të gjeturat që dalin nga raportet e inspektoratit të shfrytëzohen për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të administrimit të shkollës.

Gjithë aktivitetin e vet MASH e bazon në dokumentacionin legjislativ, si: Ligjin për Arsimin parauniversitar<sup>2</sup>, Ligjin për Maturën shtetërore<sup>3</sup>, Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e nxënësve<sup>4</sup>.

### **2.3. Qasja ndaj vlerësimit të nxënësve**

Qasja e bazuar në kompetenca, për të cilën është përcaktuar komuniteti arsimor në Kosovë, nënkupton që edhe vlerësimi i nxënësve duhet të jetë i bazuar në kompetenca, duke iu referuar hapave të zhvillimit të kurrikulës të bazuar në kompetenca dhe shtrirjes së zbatimit të saj në shkollë vendi. Mbi këtë bazë, Vlerësimi i brendshëm dhe Vlerësimi i jashtëm i nxënësve do të përqendrohet në arritjen e rezultateve të të nxënësve sipas përcaktimeve të dokumenteve kurrikulare, me fokus te rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore.

Sa i përket vlerësimit të nxënësve dhe rezultateve të tyre në Vlerësimin e brendshëm, Vlerësimin kombëtar dhe ndërkombëtar, do të analizohet efektiviteti i masave të ndërmarra për avancimin e nivelit të arritshmërisë së nxënësve.

Një aspekt i rëndësishëm është përdorimi i vlerësimeve të arritjeve të nxënësve. Vlerësimet e arritjeve të nxënësve përdoren për vendime dhe përmirësime në nivel individual (nxënës), por, gjithashtu, mund

---

<sup>1</sup>Ligji për Inspektoriatin e Arsimit (2018)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17744>

<sup>2</sup>Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 04/L-032. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17/16 Shtator 2011, Prishtinë.

<sup>3</sup>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASH), 2016 Ligji nr. 05/L -018 Për Provimin e Maturës Shtetërore.

<sup>4</sup>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Republika e Kosovës (2016). Udhëzimi Administrativ (08/2016) për Vlerësimin e Nxënësve sipas Kornizës së Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës.

të luajnë një rol në vendimet në nivelin e arsimit, për planifikimin zhvillimor, strategjik, për monitorimin dhe për intervenimin e planifikuar e sistematik që ka për qëllim përfundimtar përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për nxënës. Në këtë kontekst, Vlerësimi i jashtëm i nxënësve/Vlerësimet kombëtare dhe vlerësimet ndërkombëtare, do t'i shërbejnë sistemit si bazë për të rishikuar, përmirësuar dhe plotësuar politikatat arsimore që ndërlidhen me aspektet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies, zhvillimin në karrierë të mësimdhënësve dhe të tjera që lidhen me përkrahjen dhe mbështetjen e të nxënësve.

#### **2.4. Iniciativat dhe zbatimi i Kornizës së Vlerësimit**

Çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Kornizës të Vlerësimit, janë edhe aktivitetet që do të zhvillohen nga projekti i Binjakëzimit me Qendrën e vlerësimeve CITO. Ky projekt ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të stafit të DSCVSL-së, përkatësisht ngritjen e një qendrije të vlerësimit siç e parasheh Ligji për Arsimin parauniversitar (MASH).

Institucionet dhe akterët që merren me zhvillimin dhe me zbatimin e politikave arsimore, janë të interesuar të kryejnë vlerësime objektive dhe të qëndrueshme, prandaj në rend të parë është bërë prioritet hartimin i Standardeve të vlerësimit, i Standardeve të performancës për nivele të shkollimit, si dhe hartimi i Kritereve të standardizuara për format e vlerësimit për arritje të nxënësve dhe hartimi i Kritereve të standardizuara të raportimit të rezultateve të vlerësimit.

Korniza e Vlerësimit do të ndihmojë vlerësimin e nxënësve në institucionet e shkollimit të nivelit Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë. Do t'u ofrojë atyre fakte mbi kritere të bazuara për përzgjedhjen e nxënësve për shkollim të mëtutjeshëm po ashtu do t'u ofrojë një pasqyrë për format, kriteret dhe qëllimet e vlerësimit si dhe për mënyrën e përdorimit të rezultateve që dalin nga vlerësimet, për planifikim më praktik, me qëllim të ngritjes së cilësisë.

Politikë-bërësve do t'u ndihmojë për rishikimin e kurrikulave, teksteve mësimore, programeve të trajnimit, si dhe rishikimin e sistemit arsimor në tërësi, për ta bërë atë më cilësor dhe më të efektshëm.

#### **2.5. Dokumentet relevante**

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 04/L-032 (2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2011/ e rishikuar 2016). Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.
4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës.(2016). Kurrikulat Bërthamë të rishikuara për (i) Arsimin Parafillor dhe Fillor, (ii) Arsimin<sup>n</sup> e Mesëm të Ulët, dhe (iii) Arsimin<sup>n</sup> e Mesëm të Lartë. Prishtinë.  
<http://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/02/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>
5. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Republika e Kosovës (2016). Udhëzimi Administrativ (08/2016) mbi Vlerësimin e Nxënësve sipas Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës.
6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Udhëzimi Administrativ nr. 24/2016 për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar.
7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar të Kosovës 2016-2020.
8. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Raportet e PISA-s 2015.

9. OECD (2013). Sinergjitë për mësim më të mirë: një perspektivë ndërkombëtare për vlerësimin. Paris: OECD.
10. Scheerens, J., Glas, C., & Thomas, S.M. (2003). Vlerësimi, Vlerësimi dhe Monitorimi i Arsimit, një Qasje Sistematike. Lisse: Swets&Zeitlinger.
11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2018). Raporti vjetor statistikor me tregues arsimorë 2017-2018. MASH, Prishtinë.  
[https://MASH.rks-gov.net/uploads/2018/12/raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2017-18\\_1.pdf](https://MASH.rks-gov.net/uploads/2018/12/raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2017-18_1.pdf)
12. Ligji nr. 03 / L-068 Për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës (21 maj 2008). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

## **KAPITULLI III - VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Në këtë kapitull fillimisht jepet një përmbledhje e karakteristikave të përgjithshme të vlerësimit të nxënësve, pastaj përvijohen drejtimet e ardhshme për vlerësimin e nxënësve. Ky strukturim i përmbajtjes së tekstit është bërë me qëllim që të paraqesim një ndërlidhje në mes të dokumenteve që rregullojnë vlerësimin e nxënësve dhe drejtimeve të ardhshme të vlerësimit të nxënësve, që parasheh korniza.

### **3.1. Karakteristikat e përgjithshme të vlerësimit të nxënësve**

#### **3.1.1. Korniza legislative e vlerësimit të nxënësve**

Sistemi i vlerësimit të nxënësve në Kosovë rregullohet me legjislacionin e bazuar në dokumentet e mëposhtme relevante, si: a) “Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës”, b) “Kurrikulat Bërthamë për Tre (3) Nivele të Arsimit Parauniversitar”, dhe c) “Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Nxënësve, sipas Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës”. Ky legjislacion vlen për vlerësimin e të gjithë nxënësve, të të gjitha shkollave publike dhe private, si dhe për të gjitha institucionet e niveleve të tjera të arsimit në Kosovë dhe mbështetet në rezultate specifike të të nxënësve të përcaktuara në Kornizën e kurrikulës, Kurrikulat bërthamë, Programet mësimore dhe Planet mësimore.

Korniza e Kurrikulës e vitit 2016 përshkruan qëllimet e Arsimit Parauniversitar dhe kompetencat kryesore që duhet të arrihen nga nxënësit pas përfundimit të Arsimit të Mesëm të Lartë. Korniza e Kurrikulës, gjithashtu, përshkruan qëllimet e përgjithshme, parimet dhe llojet e vlerësimit, për të siguruar ndërlidhjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit të vlerësimit të nxënësve. Qëllimi i përgjithshëm i vlerësimit të nxënësve, siç përcaktohet në Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Nxënësve, sipas Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, është mbledhja e informatave për mbështetjen e nxënësve në zotërimin e rezultateve të të nxënësve, përcaktimi i niveleve të performancës, raportimi i rregullt i progresit dhe orientimi për arsimim të mëtutjeshëm.

Sistemi i vlerësimit të nxënësve i përshkruar në Kornizën e Kurrikulës, përcakton rezultatet e të nxënësve që duhet të vlerësohen, kohën kur duhet të bëhet vlerësimi, procedurat e përgjithshme dhe kush kryen vlerësimin për secilin lloj të vlerësimit dhe për secilin nivel të arsimit. Vlerësimi i nxënësve është i bazuar në rezultatet e përcaktuara të të nxënësve sa i përket kompetencave kryesore, Programeve mësimore, Planeve mësimore, si dhe lëndëve e fushave lëndore në shkallët kryesore të kurrikulës dhe të niveleve të arsimit në Arsimin parauniversitar në Kosovë (Tabela 1). Përmes sistemit të vlerësimit të nxënësve, merren informata të vazhdueshme rreth cilësisë së nxënësve të nxënësve dhe mësimdhënies, duke iu referuar kurrikulës. Në bazë të këtij informacioni, merren vendime dhe planifikohen veprime që mbështesin nxënësit në përmirësimin e kompetencave të tyre dhe përparimin e procesit të mësimdhënies dhe të vlerësimit.

**Tabela 7. Hierarkia e dokumenteve të kurrikulës, sistemi i rezultateve të të nxënës dhe lloji i vlerësimit**

Hierarkia e dokumenteve të kurrikulës	Sistemi i rezultateve të të nxënës	Lloji i vlerësimit
<b>Korniza Kurrikulare e Kosovës</b>	Rezultatet kryesore të të nxënës, të cilat shprehin nivelin e duhur të arritjes së kompetencave kryesore, për secilin nivel të Arsimit parauniversitar	Vlerësimi shtetëror në fund të klasës V “Certifikata” në fund të klasës V Vlerësimi shtetëror në fund të klasës IX “Certifikata” në fund të klasës IX Vlerësimi shtetëror pas përfundimit të Shkollës së Mesme të Lartë “Certifikata” e Maturës shtetërore
<b>Kurrikula Bërthamë për Shkallët Kryesore të Kurrikulës 1-6</b>	Rezultatet e të nxënës, të cilat shprehin nivelin e duhur të arritjeve të kompetencave kryesore pas përfundimit të secilës shkallë kryesore kurrikulare	Vlerësimi në shkollë “Certifikata shkollore” “Diploma profesionale”
	Rezultatet e të nxënës për secilën fushë kurrikulare gjatë shkallës kryesore të kurrikulës	Vlerësimi përfundimtar në nivel të klasës. “Libreza e notave” të nxënësve "Dëftesa e notave"
<b>Programi Mësimor Lëndor</b>	Rezultatet e të nxënës sipas lëndëve për çdo klasë	Vlerësimi përfundimtar "Dëftesa e notave" Vlerësimi formativ Vlerësimi përmbledhës “Portfolio e nxënësve”

Burimi: Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës

### 3.1.2. Qëllimet dhe parimet e vlerësimit të nxënësve

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të mbështesë dhe të përmirësojë të nxënës e nxënësve. Vlerësimi siguron informata të përhershme për nivelin e arritjes, cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënës, si dhe ofron informata kthyesë për institucionet arsimore dhe të gjithë akterët e tjerë (Kurrikula bërthamë).

Kurrikula bërthamë përshkruan qëllimet e mëposhtme të vlerësimit:

- Mbështetja dhe përmirësimi i të nxënës;
- Raportimi i rregullt i progresit individual të nxënës;
- Arritja e suksesshme e kompetencave siç përcaktohet në Kurrikulë;
- Vendosja dhe monitorimi i standardeve të arritjes për secilin nivel arsimor;
- Krahasimi, certifikimi dhe orientimi i nxënësve për arsimim të mëtutjeshëm.



### Parimet themelore të vlerësimit

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka zhvilluar Standardet e Vlerësimit dhe Kodin e Etikës së Vlerësimit të Nxënësve. Vlerësimi duhet të jetë gjithmonë në pajtim me normat e këtyre dy dokumenteve, që definojnë:

- Vlerësimi duhet gjithnjë t'u referohet kompetencave kryesore dhe rezultateve të të nxënësve, sipas fushave kurrikulare, fushave lëndore, niveli të klasës, të shkallës dhe nivelit të shkollimit.
- Instrumentet e vlerësimit duhet të rregullohen gjithmonë në varësi të objektivit të vlerësimit.
- Forma e vlerësimit, lloji dhe veçanërisht mënyra në të cilën raportohen rezultatet, duhet të pasqyrojnë gjithmonë objektivin e vlerësimit.
- Mënyra e ndërtimit të vlerësimit duhet të jetë gjithmonë transparente dhe e drejtë.
- Vlerësimi gjithmonë duhet të bëhet me standardet më të larta etike dhe me përgjegjësi e përgjegjshmëri.

Vlerësimi është një proces i mbledhjes dhe i diskutimit të informatave nga burime të shumta dhe të ndryshme për të zhvilluar një kuptim të thellë të asaj që nxënësit dinë, kuptojnë dhe mund të krijojnë nga njohuritë e tyre, si rezultat i përvojave të tyre arsimore.

Vlerësimi synon mbi të gjitha të përmirësojë nxënien dhe arritjet e nxënësve dhe duhet të sigurojë informata të vazhdueshme dhe të plota mbi arritjet e nxënësve. Vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e procesit të mësimdhënies dhe nxënies dhe duhet të bazohet në metoda të ndryshme dhe të shumta.<sup>1</sup> Vlerësimi duhet të jetë i drejtë, transparent, i vlefshëm dhe i sigurt.

Sipas Udhëzimit Administrativ 8/2016 një vlerësim është i DREJTË kur nuk favorizon nxënësit bazuar në prejardhjen, gjininë, ose përvojën e tyre të mëparshme me mësimdhënësin dhe/ose metodën e mësimdhënies. Vlerësimi duhet të jetë i paanshëm gjatë zbatimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, interpretimit dhe përdorimit të rezultateve.

Vlerësimi është *transparent* kur nxënësit e dinë se çfarë dhe cilat janë qëllimet e të nxënësve, cilat standarde pritet që ata t'i arrijnë dhe si do të vlerësohen arritjet e tyre. Nxënësit dhe prindërit duhet të kenë qasje në metodat e vlerësimit që do të përdoren, dhe rezultatet e përdorimit të tyre.

Vlerësimi konsiderohet *i vlefshëm* nëse prodhon informata të rëndësishme për qëllimin dhe përmbajtjen e vlerësimit, dhe zbatohet njëjtë për të gjithë nxënësit, dhe nuk përfshin gjykime për sjelljen, aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve, pra nuk përfshin vlerësim specifik për nxënës të caktuar.

Cilësia e vlerësimeve (të Jashtme) të nxënësve mund të bëhet përmes shtatë kritereve<sup>2</sup>

1. *Specifikimi i qëllimit dhe i përdorimit të vlerësimit* - Çështja kryesore këtu është nëse është arritur vlerësimi qëllimi i synuar i testit dhe nëse nuk ka pasoja të pafavorshme ose të qëllimita;
2. *Cilësia e materialit të vlerësimit* - Çështja kryesore këtu është nëse i gjithë materiali i vlerësimit, (manuali, udhëzimet, modeli dhe formati i kërkesave, paraqitja e testit, etj.) ka një cilësi të kërkuar. Kërkesat dhe procedurat e pikëve, (çelësat, skema e notimit) si dhe rrethanat e vlerësimit, duhet të jenë të përcaktuara mirë.
3. *Përfaqësimi i përmbajtjes së vlerësimit* - Çështja kryesore, me këtë rast, është nëse vlerësimi është vlerësim matjeje e njohurive, e aftësive ose e shkathtësive që synohet të maten, e jo e aftësive ose e shkathtësive që nuk synohen të maten;
4. *Besueshmëria e vlerësimit* - Çështja kryesore, me këtë rast, është nëse saktësia e matjes së vlerësimit është mjaft e lartë për qëllimin e synuar;

<sup>1</sup>Udhëzimi administrativ. Zbatimi i Standardeve të Vlerësimit.

<sup>2</sup>CITO, 2018. Raporti fillestar. Qasja e binjakëzimit të integruar në projektin KESIP.

5. *Përcaktimi i standardeve dhe/ose normave dhe zbatimi i normave (përfshirë barazimin)* - Çështja kryesore, me këtë rast, është nëse normat (normat relative ose standardet) për vlerësim janë krijuar duke përdorur praktika (më të mira) të shëndosha dhe të dëshmuara. Duhet të vendosen procedura që garantojnë se normat nuk ndryshojnë lidhur me administrimin e vlerësimit;
6. *Informata mbi administrimin dhe sigurinë* - Çështjet kryesore, me këtë rast, janë nëse modeli i vlerësimit përshkruhet në atë mënyrë që në praktikë vlerësimi të mund të bëhet në kushte të standardizuara dhe nën masat e mjaftueshme për të parandaluar MASHrimin;
7. *Paanësia e vlerësimit* - Çështja kryesore, me këtë rast, është nëse vlerësimi është i drejtë për të gjithë anëtarët e grupit të synuar. Për shembull, nëse një vlerësim është shtypur me ngjyra, a është i tillë që, nxënësit, që nuk i dallojnë ngjyrat, do të kenë të njëjtat gjasa t'i përgjigjen saktë pikës si nxënësit që nuk e kanë këtë aftësi?

Korniza udhëzon që të gjitha këto kritere të jenë bazë për procesin e vlerësimit të nxënësve.

### 3.1.3. Llojet e vlerësimit

Gjatë Arsimit parauniversitar, vlerësohet progresi i vazhdueshëm dhe niveli i arritjeve së rezultateve të të nxënësve, siç përcaktohet me Kornizën Kurrikulare të Kosovës, Kurrikulën Bërthamë për Shkallët Kryesore të Kurrikulës, Programet dhe Planet mësimore të lëndës. Procesi i vlerësimit, bazuar në Kornizën Kurrikulare të Kosovës, është i orientuar te Vlerësimi i brendshëm dhe Vlerësimi i jashtëm. Vlerësimi i brendshëm ose Vlerësimi me bazë në shkollë synon të mbështesë dhe forcojë të nxënësve dhe raportimin e rregullt të përparimit individual të nxënësve. Vlerësimi i jashtëm, nga ana tjetër, është një vlerësim i standardizuar për të matur nivelin e arritjeve të rezultateve të të nxënësve, zotërimin e kompetencave në fund të niveleve I, II dhe III të Arsimit parauniversitar. Kosova, gjithashtu, që nga viti 2012, merr pjesë në vlerësimet ndërkombëtare, në të cilat, në një nivel kombëtar, vlerësohen kompetencat dhe aftësitë e nxënësve (PISA/ 2015 – 2018 – 2021, TIMSS/2019, PIRLS/2022). Prandaj, aktualisht mund të dallohen tri lloje të vlerësimit: Vlerësimi i brendshëm, Vlerësimi i jashtëm dhe Vlerësimi ndërkombëtar. Këto tri lloje të procedurave të vlerësimit diskutohen në pjesën si në vijim.

## 3.2. Procedurat e vlerësimit të nxënësve

### 3.2.1. Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivelin shkollë/klasë nga mësuesi/vlerësuesi i lëndëve përkatëse dhe sipas përshkrimit të procedurave dhe të kritereve për secilin lloj të Vlerësimit të brendshëm, të rregulluar me UA 8/2016. Fokusi i Vlerësimit të brendshëm është të mbështesë të nxënësve e nxënësve për të zotëruar kompetencat. Kjo arrihet duke kombinuar Vlerësimin formativ (për të nxënë) me Vlerësimin përmbljedhës (të të nxënësve).

Përmes Vlerësimit formativ (për të nxënë), mësuesi/vlerësuesi mbikëqyr progresin e nxënësve gjatë procesit mësimor, mbledh informata për vendimmarrje, në mënyrë që të sigurojë mbështetjen e nevojshme për të nxënësve e nxënësve.

Përmes Vlerësimit përmbljedhës (i të nxënësve), mësuesi/vlerësuesi përcakton arritjet e nxënësve në përfundim të një detyre të caktuar, temës, kapitullit, periudhës së mësimin, për të dhënë notat dhe për të vërtetuar nxënësve për të mësuarit e mëtejshme. Vlerësimi përmbljedhës, gjithashtu, përdoret për të përcaktuar efektivitetin e të nxënësve ose programin kurrikular.

### Llojet e vlerësimeve të brendshme

Korniza Kurrikulare përcakton tri lloje të Vlerësimit të brendshëm, të cilat janë:

- Vlerësimi i vazhdueshëm (Formativ dhe Përmbledhës)
- Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësimi i shkallës kryesore

Korniza e Kurrikulës për secilin nivel të arsimit ka përcaktuar periudhën e zbatimit të secilit lloj vlerësimi, bartësin/personin përgjegjës, qëllimet kryesore dhe mënyrat e dokumentimit/evidentimit të arritjeve të nxënësve. Këto aspekte përshkruhen në Tabelën si në vijim.

**Tabela 8. Vlerësimi i brendshëm, qëllimet e vlerësimit dhe të dokumentimit të rezultateve të vlerësimit**

Llojet e vlerësimit dhe periudha e realizimit	Bartësit	Qëllimet kryesore sipas llojeve të vlerësimit	Dokumentimi/evidentimi i rezultateve të vlerësimit
<b>Vlerësimi i vazhdueshëm</b> - Bëhet gjatë procesit të të nxënësve (Vlerësimi formativ), dhe - Në fund të çdo teme mësimore, njësie tematike apo periudhe të mësimi (Vlerësimi përmbledhës)	Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse	Mbështetja e të nxënësve të nxënësve; Informimi dhe raportimi; Vendosja e notës; Planifikimi për mbështetjen e vazhdueshme të të nxënësve të nxënësve.	Evidentimi në notesin e punës së mësimdhënësit; Evidentimi në libër të klasës i notave për periudhat e caktuara të vitit mësimor dhe/apo ditarin elektronik.
<b>Vlerësimi përfundimtar</b> Bëhet në fund të vitit mësimor/vitit shkollor	Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse	Vendosja e notës përfundimtare në fund të vitit shkollor; <sup>1</sup> Informimi dhe raportimi; Planifikimi për mbështetjen e të nxënësve të nxënësve në vitin vijues.	Notat përfundimtare evidentohen në librin e klasës, në librin amë/dhe/apo në ditarin elektronik, si dhe në dëftesën për klasë.
<b>Vlerësimi për shkallë</b> Realizohet në fund të çdo shkalle kurrikulare, përkatësisht në fund të klasës 2, 5, 7 dhe 11.	MASH/DSCSVL/ Ekipi profesional/Këshill i i mësimdhënëseve brenda një shkalle kurrikulare.	Verifikimi i nivelit të arritjes së rezultateve të të nxënësve dhe zotërimi i kompetencave kryesore në nivel të një shkalle dhe fushe kurrikulare; Planifikimi për mbështetjen e të nxënësve të nxënësve në vitin vijues; Informimi dhe raportimi për prindërit dhe për institucionet arsimore.	Evidentimi përshkruar bëhet: - në një raport të veçantë të shkollës për secilin nxënës dhe në librin e klasës - në rubrikat e veçanta për këtë vlerësim; - në raporte përmbledhëse të aktiveve profesionale dhe këshillave të klasave.

Burimi: Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës.

<sup>1</sup>Shkalla e fundit e një lënde mësimore pasqyron nivelin e performancës së nxënësve gjatë një viti shkollor. Nota përfundimtare formohet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Nxënësve sipas Kurrikulës së Re.

### **3.2.2. Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë procesit të mësimit (Vlerësimi formativ)**

Vlerësimi i brendshëm i nxënësve bëhet nëpërmjet Vlerësimit të vazhdueshëm dhe Vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi i vazhdueshëm realizohet përmes Vlerësimit formativ dhe Vlerësimit përmbledhës.

Vlerësimi i vazhdueshëm bëhet në funksion të mësimdhënies dhe të të nxënësve. Vlerësimi ka të bëjë me tërësinë e mjeteve, të teknikave, të metodave dhe të praktikave të përdorura nga mësimdhënësit për të testuar, kontrolluar, analizuar dhe matur nivelin e njohurive, aftësive dhe performancës së nxënësve.

Për të vlerësuar kompetencat e nxënësve, është e rëndësishme që mësimdhënësit të zgjedhin teknikat dhe instrumentet e vlerësimit që u mundësojnë nxënësve të demonstrojnë dhe të shfaqin njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e tyre, dhe jo vetëm njohuritë faktike. Në këtë mënyrë, mësimdhënësit japin informata për cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënësve, përparimin e nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave.

Është shumë e rëndësishme që mësimdhënësit të përdorin instrumente të ndryshme të vlerësimit në procesin e të mësuarit për t'u siguruar që nxënësit po përparojnë dhe po arrijnë rezultate pozitive. Këto instrumente të vlerësimit duhet të jenë të ndryshme në varësi të llojeve të të nxënësve që do të vlerësohen, dhe duhet të plotësohen në baza të vazhdueshme dhe periodike.

Instrumentet e vlerësimit, që mësimdhënësit mund të përdorin në procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në Vlerësimin e vazhdueshëm (formativ), janë angazhimi në klasë, detyrat e shtëpisë, prezantimet me gojë, detyrat individuale, testet, listat kontrolluese, posterët, debatet, esetë, kuizet, portfoliot, projektet, puna praktike, puna laboratorike, projektet kurrikulare dhe ndër-kurrikulare dhe vëzhgimi i mësimdhënësve. Në përzgjedhjen e këtyre instrumenteve të vlerësimit, mësimdhënësit duhet të marrin parasysh ekuilibrin midis njohurive, të kuptuarit, shkathtësive, qëndrimeve, kompetencave, siç përshkruhen në rezultatet e të nxënësve.

### **3.2.3. Vlerësimi i vazhdueshëm në fund të çdo teme mësimore, njësie tematike ose periudhe mësimore (Vlerësimi përmbledhës)**

Vlerësimi përmbledhës realizohet në tri periudha mësimore gjatë një viti mësimor ku për secilën periudhë mësimore vlerësimi bëhet në bazë të rezultateve të të nxënësve, që arrihen në periudhën përkatëse, me instrumente të ndryshme, të hartuara sipas kriterëve të caktuar të vlerësimit.

Rezultatet e Vlerësimit përmbledhës evidentohen me komente dhe nota për nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënësve. Nota e Vlerësimit përmbledhës për një periudhë të caktuar mësimore formohet prej dy vlerësimeve përmbledhëse Vp1 dhe Vp2. Nxënësit e nivelit I (Klasat përgatitore dhe klasat 1-5) vlerësohen vetëm me Vp1, ndërsa nxënësit e nivelit II, III, IV, V dhe VI vlerësohen me Vp1 dhe me Vp2. Vlerësimi përmbledhës 1 (Vp1) realizohet për një periudhë mësimore që realizohet përmes instrumenteve të ndryshme (p.sh. detyra të shtëpisë, angazhimi në klasë, kuize, debate, prezantime me gojë, ese, teste, projekte, punë praktike dhe portfolio), ndërsa Vlerësimi përmbledhës 2 (Vp2) realizohet përmes një instrumenti vlerësues, që përshtatet me specifikat e lëndës/fushës mësimore për matje objektive të arritjeve të nxënësve, dhe duhet të jetë i bazuar në një plan të vlerësimit (nga aktivitetet profesionale) dhe i cili duhet të harmonizohet në nivel shkolle për të mos u ngarkuar nxënësit.

Vlerësimet përmbledhëse shënohen me një notë numerike: 1 (e pamjaftueshme, 0 -39%), 2 (e mjaftueshme, 40-59%), 3 (e mirë, 60 - 79%), 4 (shumë e mirë, 80-89%), 5 (e shkëlqyeshme, 90-100%).

Nota përfundimtare e Vlerësimit përmbledhës të një lënde për një periudhë të caktuar mësimore të të nxënësve, formohet nga Vp1 (60%) dhe Vp2 (40%) dhe evidentohet në ditarin personal të mësimdhënësit dhe në librin e klasës.

### **3.2.4. Vlerësimi përfundimtar**

Vlerësimi përfundimtar në një lëndë mësimore realizohet në fund të çdo klase dhe pasqyron nivelin e performancës së nxënësve si vlerësim i përfundimit të vitit mësimor. Ky vlerësim mbështetet në rezultatet specifike të të nxënësve të përcaktuara brenda planeve dhe programeve për klasë. Nota përfundimtare (vjetore) formohet me mesataren aritmetike të notave në tri periudha të caktuara mësimore: nota (1) është mesatarja e notave (1.00-1.49), nota (2) është mesatarja e notave (1.50-2.49), nota (3) është mesatarja e notave (2.50-3.49), nota (4) është mesatarja e notave (3.50-4.49), nota (5) është mesatarja e notave (4.50-5.00).

### **3.2.5. Vlerësimi i shkallës kryesore**

Vlerësimi i shkallës ka për qëllim verifikimin e arritjes së rezultateve të nxënësve në nivel të shkallës kurrikulare të fushave përkatëse të zotërimit të kompetencave kryesore, me qëllim të organizimit të mësimdhënies të progresi i vazhdueshëm i arritjes së këtyre kompetencave. Vlerësimi për shkallë realizohet në nivel shkollë për fushë/lëndë dhe përfshin Vlerësimin e përfundimit të shkallës të kurrikulës (në fund të shkallës I, II, III dhe V), përkatësisht në fund të klasës përkatëse (2, 5, 7 dhe 11), Vlerësimi i shkallës kryesore bëhet nga ekipi profesional/këshillat e mësimdhënësve, që kanë zbatuar kurrikulën brenda një shkalle kurrikulare. Rezultatet e Vlerësimit të shkallës përdoren nga shkolla dhe DKA për përmirësimin dhe për avancimin e praktikave të punës në organizim, planifikim, mentorim, monitorim dhe mbikëqyrje të punës që realizohet në shkollë. Këto rezultate të Vlerësimit të shkallës raportohen në MASH, bashkë me raportet e tjera të suksesit të nxënësve. Vlerësimi i shkallës planifikohet, përgatitet dhe realizohet në të gjitha shkollat dhe në tërë vendin, në bashkëpunim me: MASH, komunë, shkollë dhe mësimdhënës. Vlerësimi i shkallës kryesore në Kosovë është duke u realizuar që nga viti 2017 përmes Testit të standardizuar të tipi letër/laps të hartuar nga MASH/DSCSVL dhe ky vlerësim administrohet në lëndët: Gjuhë shqipe, Gjuhë Angleze, Matematikë dhe në lëndët e tjera. Vlerësimi i shkallës bëhet nga mësimdhënësit në bazë të listës së kontrollit të rezultateve të të nxënësve për shkallë të kurrikulës për fushat lëndore dhe kompetencat kryesore, (të përgatitur nga aktivitetet profesionale) të cilat i verifikojnë këto arritje të nxënësve sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në rubrikat përkatëse për çdo rezultat mësimor.

Ndërsa Vlerësimi i shkallës në lëndët mësimore që nuk janë të përfshira në Testin e standardizuar, bëhet nga Aktivitetet profesionale dhe Këshillat e klasave, duke u bazuar në dëshmitë dhe raportet e vlerësimit të mësimdhënësve.

Vlerësimi i shkallës shënohet me notë në formë të shkronjës (A, B, C, D). Nota A - është performancë e shkëlqyeshme, nota B - performancë shumë e mirë, nota C - performancë e mirë, dhe nota D - performancë e mjaftueshme.

### **3.2.6. Udhëzimet e Kornizës për Vlerësimin e brendshëm të nxënësve**

Korniza e Vlerësimit të Nxënësve, udhëzon që të respektohen kërkesat e kurrikulës për vlerësimin e nxënësve, sipas së cilës:

- Vlerësimi i nxënësve duhet të udhëhiqet nga parimet e vlerësimit;
- Vlerësimi i brendshëm duhet të bëhet në nivel shkollë/klase nga mësimdhënësit e shkollës dhe sipas përshkrimit të procedurave e kriterëve për secilin lloj të Vlerësimit të brendshëm, të rregulluara me akte nënligjore;

- Fokusi kryesor i Vlerësimit të brendshëm të jetë mbështetja e të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe kjo të arrihet më së miri nga kombinimi i Vlerësimit formativ (për të nxënë) dhe Vlerësimit përmbledhës (i të nxënësve).
- Vlerësimi i brendshëm duhet t'u mundësojë të gjithë nxënësve të shprehin njohuritë e reja dhe të tregojnë nivelin e zotërimit të kompetencave duke përfshirë:
  - Gjerësinë dhe thellësinë e tyre;
  - Gatishmërinë për t'u përgjigjur sfidave të nivelit të përcaktuar me rezultatet e të nxënësve;
  - Aftësinë për t'i zbatuar ato në situata dhe rrethana të reja.

### 3.2.7. Vlerësimi i jashtëm

Në sistemin arsimor në Kosovë në tre momente bëhet një Vlerësim i jashtëm, që është i fokusuar në matjen e nivelit të zotërimit të kompetencave kryesore të parapara si në kurrikulë.

Vlerësimi i jashtëm është një vlerësim i standardizuar për të matur nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënësve dhe kompetencave për fushat kurrikulare/lëndët mësimore kurrikulare që realizohet në fund të niveleve I, II dhe III të Arsimit parauniversitar. Ky vlerësim organizohet nga MASH përkatësisht nga DSCSVL, që është autoriteti qendror përgjegjës dhe i autorizuar për vlerësim në Kosovë dhe organizohet me mbarimin e klasës 5, 9 dhe 12.

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet për qëllime:

- ✓ Inspektimi dhe verifikimi të cilësisë së vlerësimit në nivel të klasës, të shkollës dhe të komunës;
- ✓ Hulumtimi dhe zhvillimi;
- ✓ Vendimmarrjeje politikë-bërëse në fusha të ndryshme të arsimit.

Korniza Kurrikulare përcakton tri vlerësime të standardizuara shtetërore në fund të niveleve formale të arsimit, të cilat realizohen për qëllime të ndryshme (Tabela 9.): hulumtim, orientim dhe certifikim.

Të gjitha këto vlerësime të jashtme, si instrument vlerësimi kanë Testin e standardizuar të tipit laps/letër me alternativa të mbyllura/zgjedhje të shumëfishta. MASH/DSCSVL përgjigjet e testit i kontrollon në mënyrë elektronike me lexues optik.

**Tabela 9. Qëllimet dhe dokumentimi për çdo vlerësim shtetëror**

Vlerësimet e standardizuara shtetërore	Qëllimet e vlerësimit	Dokumentimi/evidentimi
Vlerësimi shtetëror në fund të klasës V	Hulumtimi për aspekte të ndryshme të arsimit dhe identifikimi i nevojave për mbështetje të nxënësve në Shkollën e mesme të ulët dhe përmirësimin e Nivelit fillor. Realizohet me mostër gjithëpërfshirëse 10/15 % të nxënësve.	Evidentohen nga autoritetet qendrore/komunale për hulumtime dhe identifikim të nevojave për mbështetje të nxënësve në këtë nivel.
Vlerësimi shtetëror në fund të klasës IX	Matja e nivelit të arritjes së Kompetencave dhe orientimi për regjistrim në Shkollën e	Certifikata në fund të klasës IX

	mesme të lartë. Vlerësimi u shërben autoriteteve qendrore/komunale për zhvillimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies.	
Vlerësimi shtetëror në fund të klasës XII - <i>Provimi i Maturës shtetërore</i>	Matja e nivelit të arritjes së kompetencave dhe certifikimi për mundësi vazhdimi në studime të larta universitare. Nxënësi me arritje të pikëve të caktuara për kalueshmëri në Provimin e Maturës merr Certifikatë të Provimit të Maturës.	Certifikata e Maturës Shtetërore

Vlerësimi i jashtëm i arritjeve të nxënësve në nivelin I (mbarimi i klasës së 5) ka karakter hulumtues dhe është i bazuar në mostër (10-15% të nxënësve të klasës 5). Rezultatet e këtij vlerësimi përdoren për të vlerësuar sistemin arsimor për këtë nivel (Kapitulli VI) dhe ky vlerësim ka rezultuar i dobishëm për rritjen e cilësisë së arsimit, duke u përdorur nga autoritetet komunale dhe qendrore të arsimit për hulumtime në aspekte të ndryshme të arsimit dhe për identifikimin e nevojave për mbështetje të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët.

Vlerësimi i klasës së 9-të është matja e arritjeve të nxënësve të nivelit II (mbarimi i klasës së 9-të). Ky ka karakter udhëzues dhe përdoret për orientim në vazhdimin e Shkollimit të mesëm të lartë. Orientimi i nxënësve në Arsimin e mesëm të lartë varet 60% nga Vlerësimi i jashtëm dhe 40% nga suksesi dhe notat gjatë shkollimit të tyre paraprak. Aktualisht testet e klasës së 9-të përbëhen nga katër grupe lëndore me një numër të caktuar kërkesash për secilën lëndë. Llogaritja e pikëve për regjistrim bëhet nga shkollat përkatëse.

Vlerësimi i fundit i jashtëm i nxënësve bëhet në nivelin III, në fund të klasës së 12-të dhe është Provimi i Maturës shtetërore. Provimi i Maturës shtetërore mbahet në dy pjesë. Provimi i Maturës shtetërore ka karakter certifikues dhe shërben për pranim në universitet – në arsimin e lartë. Këtij provimi mund t'i nënshtrohen të gjithë nxënësit, të cilët kanë mbaruar Arsimin e mesëm të lartë (gjimnaze) dhe nxënësit e Shkollave profesionale, të cilët kanë përfunduar me sukses vlerësimin e praktikës së tyre profesionale. Matura shtetërore është Vlerësimi i jashtëm i vetëm që është i rregulluar me ligj me një rezultat të kalueshmërisë (40%). Ligji për Provimin përfundimtar dhe Ligji për Provimin e Maturës shtetërore rregullojnë procedurën e organizimit, përmbajtjen, kushtet, kriteret dhe procedurat e Vlerësimit përfundimtar dhe të Maturës shtetërore në Kosovë.

### 3.2.8. Provimet për vlerësimin e nxënësve

Në Arsimin parauniversitar, organizohen edhe disa provime si në vijim:

- Provimi i Klasës, që organizohet për nxënësit të cilët për arsye shëndetësore, për arsye të braktisjes së shkollës apo ndonjë arsye objektive/subjektive, kanë munguar më shumë se (> 1/3) të kohës mësimore.
- Provimi plotësuese, që organizohet për nxënësit që ndryshojnë profilin/drejtimin arsimor. - Provimi Vjetor dhe Kontrollues, që organizohet nga Shkollat e mesme profesionale dhe Shkollat e artit, për verifikimin e aftësive të nxënësve dhe aftësimin profesional.
- Provimi pranues, që organizohet për Shkolla artistike dhe Gjimnaze të specializuara.
- Provimi përfundimtar i profesionit, që organizohet pas përfundimit të klasës së 11-të dhe të 12-të. Në Shkollat profesionale, ky provim administrohet nga shkollat dhe autoritetet

komunale të arsimit. Nxënësit që kalojnë Provimin përfundimtar të Shkollave profesionale mund të marrin pjesë gjithashtu në Maturën shtetërore.

- Provime për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (që kanë aftësi dhe shkathtësi të lartë intelektuale dhe atyre që kanë vështirësi të theksuara në të nxënë).

- Provime për vlerësimin e nxënësve të mësimin plotësues në diasporë dhe të nxënësve të kthyer nga diaspora.

### **3.2.9. Sfidat**

Në procesin e vlerësimit në Kosovë, në bazë të vlerësimeve dhe raporteve të realizuara nga DSCSVL, konsiderohen si sfida, vështirësitë si në vijim:

- Përdorimi dhe zbatimi praktik i mangët i dokumenteve arsimore parauniversitare, sipas Kornizës Kurrikulare, që promovon dhe mbështetë zhvillimin e kompetencave;
- Përzgjedhja jo e duhur dhe e përshtatshme e instrumenteve të vlerësimit nga mësimdhënësit;
- Vlerësimi i nxënësve nga mësimdhënësit, që është i bazuar kryesisht në tekste e jo në rezultatet e të nxënësve, të përcaktuara me kurrikulën e re - të bazuar me kompetenca;
- Përpilimi i kërkesave/testeve të bazuara në përmbajtje lëndore e jo të bazuara me kompetenca si në Vlerësimin e brendshëm ashtu edhe në Vlerësimin e jashtëm;
- Forma e të nxënësve dhe format e të vlerësuarit mekanik gjatë procesit mësimor nga nxënësit dhe mësimdhënësit në shkollë në vend të të nxënësve analitik (të punës kreative, të zgjidhjeve problemore, të punës kërkimore, të punës me projekte etj.);
- Hartimi i teksteve shkollore jo adekuate për klasat/nivelet përkatëse dhe pa kritere sipas kurrikulës së re të bazuar në kompetenca;
- Monitorim jo i mjaftueshëm i mësimdhënësve nga autoritetet përgjegjëse përkatëse.

Në Vlerësimet e jashtme përmenden këto vështirësi:

- Administrimi i mirëfilltë (pa kopjime) i vlerësimeve të standardizuara të jashtme; (Testi i Arritshmërisë, Provimi i Maturës shtetërore);
- Mungesa e një forme tjetër të administrimit të vlerësimeve të standardizuara të jashtme (Testi i arritshmërisë, Provimi i Maturës shtetërore); (e-Matura-Matura elektronike).

MASH dhe DKA-të kanë fituar përvojë dhe ekspertizë për zhvillimin dhe zbatimin e vlerësimeve kombëtare. Megjithatë, ka ende disa vështirësi që janë të pranishme dhe kërkojnë zgjidhje. Si sfida kryesore që përmendet në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, është parandalimi dhe zvogëlimi i MASHrimit (kopjimit) masiv, që ndodh në shkollë, gjatë procesit dhe administrimit të testimit. Përveç kësaj, duhet të rritet cilësia dhe rëndësia e Vlerësimit të jashtëm. Një cilësi më e lartë do të rrisë besueshmërinë e rezultateve të vlerësimeve të jashtme, të cilat duhet të analizohen dhe të cilave duhet kushtuar vëmendje në mënyrë që këto rezultate të vlerësimit të nxënësve të mund të përdoren për hartimin e politikave arsimore dhe të përmirësojnë cilësinë e arsimit.

### **3.2.10. Udhëzimet e Kornizës për Vlerësimin e jashtëm të nxënësve**

Korniza e Vlerësimit të Nxënësve, udhëzon që Vlerësimi i jashtëm i nxënësve të zhvillohet në drejtimet në vijim:

- Nevojitet rishikimi i të gjitha dokumenteve që lidhet me vlerësimet kombëtare;
- Vlerësimi i klasës së 5-të, të realizohet sipas nevojave dhe kërkesave;



- Vlerësimi i klasës së 9-të dhe Provimi i Maturës të përgatiten në frymën dhe formatin e udhëzimeve të Kornizës, sipas pikës 3.5., të këtij kapitulli: Zhvillimet e ardhshme në vlerësimin kombëtar të nxënësve;
- Për vlerësimet kombëtare, DSCSVL të zhvillojë udhëzime përcjellëse për përgatitjen e kërkesave/pyetjeve për vlerësim dhe përgatitjen e modeleve të testeve sipas udhëzimeve që jepen në këtë kapitull, forma për raportim pas çdo Vlerësimi të jashtëm, për publikun e gjerë dhe komunitetin arsimor, varësisht nga qëllimi i vlerësimit.

### **3.3. Kapaciteti i vlerësimit të nxënësve**

#### **3.3.1. Lloji i vlerësuesve**

Në Kosovë, ekzistojnë disa grupe vlerësuesish që merren me vlerësimin e nxënësve në Arsimin parauniversitar, në varësi të formës së vlerësimit, (të brendshëm ose të jashtëm) dhe sipas qëllimit (për shembull - certifikim i nxënësve apo vlerësimi i sistemit). Vlerësuesit e brendshëm janë mësimdhënësit, të cilët janë përgjegjës të realizojnë Vlerësimin e brendshëm në institucionet shkollore për mes një plani të vlerësimit të bazuar në standarde dhe dokumente relevante të MASH-it (Ligji për Arsimin parauniversitar, Korniza Kurrikulare dhe UA 8/2016AI, si: mësimdhënësit, aktivet profesionale, drejtoria e shkollës dhe stafi pedagogjik i shkollës.

Vlerësuesit e jashtëm janë mësimdhënësit që janë përgjegjës për kryerjen e Vlerësimit të jashtëm në institucionet shkollore përmes një planifikimi të bazuar në standarde dhe dokumente përkatëse të MASH-it, (Ligji për Arsimin Parauniversitar, Korniza Kurrikulare dhe UA 8/2016) siç është MASH/DSCSVL, si një autoritet profesional i autorizuar me Grupin e hartuesve të testit, Drejtorinë Komonale të Arsimit dhe inspektorët arsimorë.

Çdo vlerësues duhet të posedojë kompetenca për vlerësim, të ketë përgatitje akademike profesionale, të ketë njohuri për vlerësim, të ketë shkathtësi organizative, analitike dhe të komunikimit për secilin lloj të vlerësimit dhe për secilin nivel formal të arsimit, duke i zbatuar dokumentet relevante të MASH-it. Kompetencat arrihen nga dija universitare, përvoja e punës, trajnimet për vlerësim, pjesëmarrja në konferenca vendore dhe ndërkombëtare, të zhvilluara për kontekstin kosovar.

#### **3.3.2. Ndërtimi i kapaciteteve**

Procedura për ndërtimin e kapaciteteve ndryshon midis Vlerësimit të brendshëm dhe Vlerësimit të jashtëm. Meqë realizimin e Vlerësimit të brendshëm e bënë mësimdhënësi, atëherë ata kapacitetet për vlerësim duhet t'i zhvillojnë përmes takimeve të Aktiveve profesionale në shkollë, të ndihmës përmes Koordinatorit të cilësisë, Stafit pedagogjik dhe Drejtorit të shkollës. Për më tepër, ata ndërtojnë kapacitete përmes trajnimeve që synojnë posaçërisht vlerësimin, për shembull, aftësimin e mësimdhënësve në Vlerësimin formativ<sup>1</sup>, që bazohet në Standardet e Vlerësimit dhe në Kodin e Etikës për Vlerësim të Nxënësve. Në kapitujt IV dhe V, përshkruhen më gjerësisht kompetencat e mësimdhënësve dhe roli i shkollës dhe i mësimdhënësve në vlerësimin e nxënësve. MASH dhe DKA duhet të mbështesin kapacitetet e mësimdhënësve në fushën e vlerësimit të nxënësve.

Vlerësimi i jashtëm organizohet nga autoriteti i profesionalizuar DSCSVL/MASH (Sipas Ligjit të Arsimit Parauniversitar - të transformohet në Qendër të Vlerësimeve).

---

<sup>1</sup>Murchan, D., Shiel, G., Vula, E. (2018). Programi i Arsimit Themelor: Vlerësimi formativ.

Zhvillimi i kapaciteteve të personelit realizohet përmes diskutimeve brenda stafit dhe përvojave të tyre, trajnimeve të vazhdueshme për vlerësime nga organizatat ndërkombëtare, pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare për vlerësim, gjithashtu edhe përmes marrëveshjeve të binjakëzimit - stafi kryen seanca të trajnimit dhe të ndërtimit të kapaciteteve.

### **3.4. Raportimi dhe përdorimi i gjetjeve të vlerësimit të nxënësve**

Përgjegjësia kryesore për raportimin e të arriturave të nxënësve i delegohet/i takon shkollës (Vlerësimi i brendshëm) dhe DSCSVL (Vlerësimi i jashtëm). Shkollat raportojnë të arriturat e nxënësve te prindërit dhe DKA, ndërsa DKA raportojnë në MASH. DSCSVL i raporton MASH-it, DKA-së dhe shkollave.

Në Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Nxënësve, sipas Kornizës së Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, është shkruar për qëllimin, parimet dhe metodën e komunikimit në lidhje me arritjet e nxënësve dhe për rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare të Kosovës, në përputhje me politikat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës. Me ngritjen e kapaciteteve të DSCSVL-së, duhet të organizohet edhe Testi për shkallë me qëllim të raportimit për arritjet e nxënësve në Arsimin parauniversitar, i cili do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së të nxënësve ose të mësimdhënies dhe në përmirësimin e cilësisë së vlerësimit.

### **3.5. Zhvillimet e ardhshme në Vlerësimin kombëtar të nxënësve**

Aktualisht testi i mbështetur nga MASH-i ka për qëllim orientimin dhe certifikimin e nxënësve. Secili prej këtyre qëllimeve mbulohet nga vlerësime të ndryshme të jashtme. Në vijim, po i paraqesim qëllimet, instrumentet dhe tendencat e mundshme.

#### **3.5.1. Vlerësimi i nxënësve**

Aktualisht vlerësimi i mbështetur nga MASH, në nivel të nxënësve, ka një fokus përmbledhës. Më e njohura është Matura shtetërore, e cila u ndihmon nxënësve të klasës së 12-të për të marrë diplomën, e cila u jep mundësi që të mund të ndjekin arsimin e lartë që ata dëshirojnë.

Një test tjetër që lidhet me vlerësimin e nxënësve, i cili është zhvilluar nga MASH, është Testi i orientimit. Ky test u mundëson nxënësve të klasës së 9-të për të marrë informata shtesë se cili drejtim është më i përshtatshmi që ata të vijojnë mësimet në Arsimin e mesëm të lartë.

#### **Testi i klasës së 9-të**

Klasa e 9-të mund të konsiderohet si një ‘vit orientimi’ dhe është viti i fundit i Arsimit të mesëm të ulët. Një nga objektivat e vitit të orientimit është të ndihmohen nxënësit në Arsimin e mesëm të ulët me përcaktimin e opsioneve dhe të ndihmës në marrjen e vendimeve për karrierën e tyre të ardhshme. Ky mund të jetë një arsimim i mëtutjeshëm në Arsimin e mesëm të lartë, qoftë në Gjimnaze, ose në Shkollë (më të larta) profesionale. Gjithashtu, brenda këtyre dy drejtimeve, nxënësit mund të ndjekin profile të ndryshme arsimore. Testi i orientimit i klasës së 9-të, që zhvillohet nga MASH, është testi i orientimit që mund të ndihmojë përmes dhënies së informacioneve shtesë në mënyrë objektive nxënësve për drejtimin që është më i përshtatshëm për ata.

Aktualisht Testi i orientimit i klasës së 9-të ka një funksion përmbledhës pasi që konsiderohet si provim i nivelit të lartë. Ai përbëhet nga një larmi lëndësh, duke filluar nga aftësitë themelore të gjuhës amtare, Matematika dhe Anglishtja, deri te Shkencat e ndryshme Shoqërore dhe Natyrore. Drejtimi për këto teste në të ardhmen është, në mënyrë të ngjashme, si me Provimin e Maturës, më shumë testim të bazuar

në kompetenca dhe në krijimin e instrumenteve. Çështjet në lidhje me këtë ndërrim dhe ndikimi në zhvillimin e testit janë gjithashtu të ngjashme me atë të provimeve të Maturës dhe zhvendosjen e artë që duhet të bëhet si në arsim ashtu edhe në vlerësim. Rrjedhimisht, shumica e zhvillimeve në Testin e orientimit janë në sinkroni me zhvillimin e Maturës, veçanërisht me shkrimin e kërkesave dhe përshkrimin e matricës së testit.


Ndryshimi të provimet e Maturës qëndron në rregullimin dhe raportimin. Ky udhëzim i ardhshëm për Testin e orientimit mund të shtojë një rol formativ në funksionin aktual përmbledhës të testit. Nëse duam të kemi përshtatjen më të mirë ndërmjet nxënësve dhe karrierës së tyre në të ardhmen, funksioni i testit nuk është aq shumë një vendim *kalon-nuk kalon*, por më shumë një sfidë e përputhjes. Bazuar në shumë burime të informatave, përfshirë Testin e orientimit, duhet të bëhet përputhja më e mirë midis kompetencave të nxënësit dhe karrierës që duhet zgjedhur. Nëse faza tjetër e kësaj karriere është ende në sistemin e arsimit, pra në Arsimin e lartë, ekuacioni që duhet të zgjidhet është ai midis lidhjes së pikëve në lëndë të ndryshme në Testin e orientimit dhe të shkallës së suksesit në pista arsimore të ndryshme në Arsimin e mesëm të lartë.

### Provimet e Maturës

Ndryshimet që janë të arritshme në të ardhmen e afërt të Maturës, janë barazimi i versioneve të testit dhe zhvendosja në më shumë vlerësime të bazuara në kompetenca. Në një të ardhme pak më të largët, dhe ende e mundshme për t'u arritur, do të ishin standardet e përmirësuara. Kjo do të thotë që vështirësia e Provimit të Maturës mund të merret parasysht, në vendimin *kalon/nuk kalon*. Kjo mund të jetë pasojë e procedurave më të mira të barazimit, duke përdorur IRT.

Ndryshimi tjetër është zhvendosja e Maturës në një vlerësim më të bazuar në kompetencë. Kjo duhet të reflektojë një ndryshim në arsimin e Kosovës kah një qasje që është më e bazuar në kompetenca. Kjo qasje është e përkrahur nga kurrikula, por mund të mos jetë e përafuar me përvojën në klasë. Kjo e bën më të vështirë që vlerësimi të përqendrohet shumë në Vlerësimin e bazuar në kompetenca, pasi nuk do të ishte plotësisht e drejtë për të gjithë nxënësit, pasi ata mund të mos kenë shumë përvojë me Arsimin e bazuar në kompetenca. Kjo kërkon një zhvendosje të artë (Figura 1) kah praktika në klasë, që të përputhej më shumë me Kurrikulën e bazuar në kompetenca, që mund të përfshihet plotësisht me vlerësimin.


**FIGURA 1: PËRAFRIMI I PRAKTIKËS SË KLASËS DHE TRANSFORMIMI I KOMENTEVE NEGATIVE NË ATO POZITIVE - KURRIKULA**



Sfida këtu qëndron se si të bëhet ky ndryshim. Nëse nuk e ndryshojmë vlerësimin në një përvojë më të bazuar në Kompetencë, për shkak të të drejtës së nxënësve, nuk ka nevojë të ndryshojmë arsimin, sepse mësimdhënësit dëshirojnë të përgatisin nxënësit për provimet e tyre të Maturës - dhe ato nuk bazohen në Kompetenca. Ky reagim negativ duhet të shndërrohet në koment pozitiv. Për shkak se Vlerësimi është i bazuar në Kompetenca, dhe mësimdhënësit dëshirojnë të përgatisin nxënësit për provimet e tyre të Maturës, arsimi duhet të përqendrohet më shumë në një përvojë të bazuar në Kompetenca, e cila

lejon, nga ana tjetër, më shumë vlerësime të bazuara në Kompetenca. Ndryshimi i artë kërkon një transformim të reagimeve negative në reagime pozitive (Figura 2). Kjo ndryshon sfidën se si të bëhet ky transformim.

**FIGURA 2: TRANSFORMIMI I KOMENTEVE NEGATIVE NË ATO POZITIVE**



Meqenëse është më e lehtë të vlerësosh nga një pozicion më qendror si MASH, sesa të ndryshosh praktikën e klasës në të gjitha shkollat, zgjedhja e dukshme këtu është thyerja e ciklit përmes ndryshimit të vlerësimit, por pa i dëmtuar nxënësit.

Zhvillimet e reja në shkrimin e kërkesave janë mbështetës i këtij drejtimi. Kjo mund të nënkuptojë një ndryshim të vërtetë për vlerësimet në të ardhmen.

### 3.5.2. Formësimi i së ardhmes

Me ripërcaktimin e mundshëm të formës dhe të përdorimit të Testit të orientimit, ne kemi marrë tashmë një hap për mundësitë e vlerësimit të ardhshëm në Kosovë. Këto janë:

- Normat e bazuara në dëshmi
- Vlerësimi i bazuar në kompetenca
- Kombinimi i Vlerësimit të sistemit dhe i Vlerësimit formativ

Një ndërrim i rëndësishëm që është i rrënjësor në ndryshimet që janë parashikuar për vitin 2019, është zhvillimi i Normave të bazuara në dëshmi. Kjo bëhet pjesërisht përmes aplikimit të modeleve të reja kërkimore për Maturë dhe lejon barazvlerësimin e versioneve të ndryshme të testit përmes aplikimit të IRT-së. Kjo mund të japë rezultate të ndryshme të shkurtuara për versione të ndryshme të testit. Përveç barazvlerësimit - edhe me më shumë teknikë, mund të aplikohen Procedurat e vendosjes standarde të bazuara në dëshmi. Ky mund të jetë përcaktimi më klasik i standardeve siç është Procedura (e modifikuar) Angoff, ose Procedura bookmark. Megjithatë, janë të mundshme qasjet më moderne siç është 3DC (konsensusi i drejtpërdrejtë i drejtuar nga të dhënat) - metodë që funksionon brenda kornizës IRT. Në vend që të përcaktohet një përqindje e caktuar e saktë nga shprehja, të themi, 40% e saktë për provimet e Maturës, kjo jep një përqindje të bazuar në dëshmi të përgjigjes së saktë për vendimet *kalon-dështon*. Në kombinim me procedurën e barazvlerësimit, krijon më shumë rregullsi në sistemin arsimor.

Vlerësimi i bazuar në kompetenca mund të forcohet duke shtuar më shumë trajnime për zhvillimin e këtij lloji të kërkesave. Një fillim i frytshëm është bërë, por të mësosh se si të krijosh instrumente vlerësimi të bazuar në kompetenca, është një proces që kërkon kohë. I gjithë cikli *planifiko-bëj-kontrollo-vepro* duhet të përsëritet disa herë në mënyrë që të merren instrumentet e duhura. Informacioni i mbledhur nga hulumtimet pilot të vitit 2019, duhet të përfshihet në të gjithë procesin për të arritur në fazën tjetër në vitin 2020. Kjo, gjithashtu, përfshin një rishikim të mundshëm të procedurës së rishikimit. Cilësia e kërkesave dhe instrumenti i matjes në tërësi, me të vërtetë, mund të ngrihen përmes një procedure kontrollimi shumë-fazorë, multi-metodikë. Për të arritur në një proces të tillë, është e dobishme të planifikoni afatin kohor të kërkesës dhe të bëni hartimin e testit pak më ndryshe. Këto ndryshime nuk bëhen brenda natës, por duhet të jenë shumë të dobishme për të rritur cilësinë.

Kalimi nga një qasje rreptësishtë përmbledhëse në testimin me një qasjeje të shtuar më formative në testim është një vështrim tjetër në të ardhmen që do të kërkojë kohë. Megjithatë, kjo zhvendosje duhet të jetë shumë e frytshme për arsimimin në Kosovë. Në Testimin përmbledhës, qëllimi kryesor është të vlerësohet nëse nxënësi i kuptonte mësimet që i ishin dhënë më parë atij. Vendimi i bazuar në Testin përmbledhës është gjithmonë “pas faktit”. Në një mënyrë, në përmbledhje ju jeni gjithmonë vonë për të ndihmuar vërtet arsimin. Klasët veç fillojnë me tema të reja pas vlerësimit (bazuar në shkollë), ose nxënësit largohen nga shkolla pas provimeve.

Në Testimin formativ, vlerësimi është pjesë e procesit mësimor. Gabimet që bëhen janë të dobishme në mbështetje të nxënësve, duke i drejtuar ata në drejtimin e duhur - çfarë duhet të studiojnë më me zell? Ose të një mësimdhënës, duke ndihmuar si ta udhëzojë nxënësin përmes kurrikulës. Do të marrë kohë kalimi - nga testet si instrumente për të gjykuar - në mjete për të ndihmuar nxënësit.

Një mënyrë nga MASH për të zbatuar testimin Formativ është përmes zhvillimit të Testit formativ. Sigurisht, kjo do të kërkonte kohë dhe përpjekje. Mund të jetë e mundur që të kombinohet zhvillimi i testimit Formativ me Vlerësimin e Sistemit të Bazuar në Mostër (VSBM). VSBM është një tjetër formë e sistemit të vlerësimit të ardhshëm, i cili me aplikimin e IRT lejon të formojë shkallë përkatëse. Kërkesat e përdorura në VSBM mund të përdoren për të prodhuar Vlerësim të ri formativ. Përmes modeleve të zgjuara, VSBM mund të përdoret edhe në nivele të tjera e jo vetëm në klasën e 5-të dhe si i tillë do të lejojë një sistem monitorimi që me sisteme inovative të feedback-ut, me të vërtetë, të kemi një Sistem arsimor formativ që mund çojë përpara në mënyrë të konsiderueshme arsimin në Kosovë. Natyrisht, ndërtimi i një sistemi të tillë formativ është një aspiratë e ardhshme që kërkon kohë për t'u zhvilluar.

### **3.6. Dokumentet relevante**

1. Ligji nr. 03/L-018 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore.
2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2011). Udhëzimi Administrativ (08/2016) mbi Kodin Etik për Vlerësimin e Nxënësve 491/01B.
3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2011). Standardet e Vlerësimit (draft-dokument).
4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Udhëzimi Administrativ (08/2016) mbi Vlerësimin e Nxënësve sipas Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës.
5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Udhëzimi Administrativ (05/2016) Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratorëve dhe Mbikëqyrësve gjatë Procesit të Administrimit të Provimit të Maturës Shtetërore.
6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Udhëzimi Administrativ (06/2016) Kushtet dhe Kriteret e Vlerësimit të Kandidatëve me Nevoja të Veçanta.
7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2016). Udhëzimi Administrativ (06/2016) Zbatimi i Provimit Përfundimtar në Modulet Praktike për Nxënësit në Punëtori-Ndërmarrjet dhe Rezultatet e të Nxënit.
8. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2017). Udhëzimi Administrativ (16/2017) Vlerësimi Profesional i Fëmijëve me Nevoja Arsimore të Veçanta.
9. Murchan, D., Shiel, G., Vula, E. (2018). Programi i Arsimit Themelor: Vlerësimi formativ.

## **KAPITULLI IV – ASPEKTE TË VLERËSIMIT TË MËSIMDHËNËSVE NË NDËRLIDHJE ME VLERËSIMIN E NXËNËSVE**

Në këtë kapitull janë përshkruar karakteristikat kryesore - të kuadrit të mësimdhënësve dhe të vlerësimit të performancës së tyre, në relacion me vlerësimin që u bëhet nxënësve, të rolit të mësimdhënësve - për vlerësimin e nxënësve, të kapacitetit të mësimdhënësve - për të bërë vlerësimin e nxënësve, dhe të përdorimit të rezultateve të vlerësimit të nxënësve për punën e mësimdhënësve.

### **4.1. Kuadri i mësimdhënësve dhe vlerësimi i performancës së tyre**

Me legjislacionin në fuqi, mësimdhënësit në sektorin publik të arsimit në Kosovë janë nëpunës publikë profesionalë. Profesionin e mësimdhënësit në Kosovë, është pjesë e Ligjit për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës, i cili përcakton rregullat për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të profesioneve të rregulluara në Republikën e Kosovës. Sipas legjislacionit në fuqi, mësimdhënësit e Arsimit parauniversitar në Kosovë rekrutohen nga Drejtoritë Komunale të Arsimit, në bazë të normativave për kualifikimin e mësimdhënësve, të procedurave dhe të kriterëve të vendosura nga MASH dhe MPMS. Pagat e mësimdhënësve që punojnë në institucionet publike sigurohen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe menaxhohen nga Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe institucionet e tjera që kanë përgjegjësi në këtë fushë.

Përgatitja profesionale e mësimdhënësve, kohëzgjatja e studimeve universitare të mësimdhënësve Parashkollor dhe Fillor është së paku 240 ECTS, ndërsa për Mësimdhënës lëndor është së paku 300 ECTS. Ky dallim është i shprehur edhe në aspektin financiar sipas nivelit të arsimit ku mësimdhënësi është i punësuar, por ende sistemi ynë nuk ka arritur të bëjë dallimin në paga për mësimdhënësit që tregojnë performancë më të lartë në procesin mësimor. Dallimi në paga i mësimdhënësve sipas performancës së tyre, synohet të ndërlihet me sistemin e licencimit të mësimdhënësve.

Sistemi i licencimit të mësimdhënësve në Kosovë, është vendosur si instrument për:

- Llogaridhënie – përmes vlerësimit të performancës;
- Motivim – përmes gradimit dhe të ndërlihdjes së nivelit të performancës me paga të mësimdhënësve; dhe
- Zhvillim të vazhdueshëm profesional – përmes ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

Sistemi i licencimit të mësimdhënësve në Kosovë promovon gradimin në karrierë të mësimdhënësve, i cili përbëhet nga katër lloje të licencës për mësimdhënës: Mësimdhënës i karrierës; Mësimdhënës i avancuar; Mësimdhënës mentor; dhe Mësimdhënës i merituar<sup>1</sup>.

Një prej komponentëve kyçe të sistemit të licencimit të mësimdhënësve në Kosovë është Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve (VPM).

#### 4.2. Aspekte të vlerësimit të performancës së mësimit në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve

Në dokumentet që e rregullojnë vlerësimin e mësimit në Kosovë, vlerësimi i nxënësve nuk luan ndonjë rol specifik në vlerësimin individual të performancës së mësimit. Mirëpo, në kuadër të vlerësimit të performancës së mësimit, disa kërkesa lidhen me kapacitetin e mësimit për kryerjen e vlerësimit të nxënësve. Kjo ndërlidhje në radhë të parë ekziston për të realizuar qëllimin e parë të Vlerësimit të Performancës së Mësimit (VPM): *Të sigurojë që nxënësit të përfitojnë nga shkolla dhe performanca e mësimit që performon në bazë të kompetencave për mësimit të mirë.*

Standardet për mësimit, të përvijuara në dokumentin Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimit në Kosovë (2017), në mënyrë të drejtpërdrejtë e ndërlidhin vlerësimin e performancës së mësimit me vlerësimin e nxënësve. Kjo ndërlidhje përshkruhet në Tabelën në vijim, ku pasqyrohen të gjitha standardet për mësimit dhe ku veçohet standardi që lidhet me vlerësimin e nxënësve.

**Tabela 10. Standardet për mësimit<sup>2</sup>**

Standardet për mësimit
1. Njeh dhe i mbështet vlerat dhe kriteret kryesore që janë vendosur nga MAST-i / Përgjegjësitë karshi detyrimeve dhe obligimeve të punës;
2. Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve dhe mësimit;
3. Demonstron njohje të kurrikulës/përmbajtjes lëndore dhe metodikës së didaktikës profesionale të lëndës;
4. Planifikon zbatim efektiv të mësimit dhe mësimit;
5. Planifikon vlerësimin e vazhdueshëm, ofron komente kthyes dhe raporton sa i përket mësimit të nxënësve;
6. Angazhohet për zhvillim të vazhdueshëm profesional; dhe
7. Angazhohet profesionalisht me kolegë, prindër dhe bashkësi.

<sup>1</sup>Më gjerësisht, shih: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Republika e Kosovës (2017). Udhëzimi Administrativ nr. 5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimin e Mësimit në Karrierë.

<sup>2</sup>Më gjerësisht, shih: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2017). Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimit në Kosovë.

<https://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/04/kornize-strategjike.pdf>

Siç mund të shihet, vlerësimi i nxënësve reflektohet në standardin nr. 5 (*Planifikon vlerësimin e vazhdueshëm, ofron komente kthyesë dhe raportin sa i përket mësimin të nxënësve*), i cili e siguron ndërlidhjen e vlerësimit të performancës së mësimdhënësit me praktikën e vlerësimit të nxënësve nga mësimdhënësit. Në këtë standard përmenden edhe disa tregues për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve si dhe për shkathtësitë dhe praktikën profesionale të tyre për vlerësimin e nxënësve (përshkruar në seksionin 4.3). Ndërveprimi midis vlerësimit të performancës së mësimdhënësit me vlerësimin e nxënësit pasqyrohet më së miri në raportet e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, ku në raportet duhet të shkruhet edhe niveli i kompetencave të mësimdhënësit për standardin 5 dhe treguesit e performancës së këtij standardi.

### **4.3. Roli i mësimdhënësve në vlerësimin e nxënësve**

Roli i mësimdhënësve në vlerësimin e nxënësve është i përshkruar në udhëzimet administrative që rregullojnë vlerësimin e nxënësve, në Kornizën Kurrikulare (2016), Kurrikulat Bërthamë (2016), si dhe në të gjitha programet mësimore për lëndë dhe klasë. Udhëzimet për vlerësimin e nxënësve në këto dokumente janë të përgjithshme dhe orientuese për mësimdhënësit dhe përgjegjës të tjerë që kanë rol në vlerësimin e nxënësve. Këto udhëzime i referohen kryesisht parimeve të vlerësimit, llojeve të vlerësimit, qëllimeve të vlerësimit dhe dokumentimit të vlerësimit (Kapitulli III). Përshkrimi i udhëzimeve për vlerësimin e nxënësve në dokumentet kurrikulare dhe programet mësimore përgjithësisht është i njëjtë, pavarësisht niveleve të arsimit apo të shkallëve kurrikulare.

Roli dhe kapaciteti i mësimdhënësve në vlerësimin e nxënësve në mënyrë më të detajuar është përvijuar në kapitullin e dokumentit Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë, ku zbërthehen kompetencat e mësimdhënësit në faza të ndryshme të karrierës, përkatësisht në standardin 5 për mësimdhënësit (i përmendur në seksionin e mëparshëm) i cili ndërlidhet me vlerësimin e nxënësve. Në këtë standard, janë përcaktuar tre tregues për kompetenca të mësimdhënësve në fushën e vlerësimit të nxënësit:

*5.1 Planifikon plotësimin e zbrazëtive të të arriturat e nxënësve*

*5.2 I interpreton të dhënat nga vlerësimi i nxënësve për të përmirësuar nxënien e tyre*

*5.3 Raporton sa i përket arritjeve të nxënësve*

Në raport me sistemin e licencimit, për çdo tregues dhe lloj të licencës së mësimdhënësit përshkruhen aftësitë dhe kompetencat e mësimdhënësve për të gjithë treguesit e standardeve për mësimdhënësit, pra edhe për standardin 5, i cili u referohet aspekteve në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve<sup>1</sup>.

Mësimdhënësi/ja për ta përmbushur rolin e tij/saj në vlerësimin e nxënësve, në raport me kërkesat e standardit për mësimdhënësit në fushën e vlerësimit të nxënësve dhe të treguesve të këtij standardi, duhet të përqendrohet në:

- planifikimin e vlerësimit të nxënësve;
- vlerësimin e vazhdueshëm të përparimit të nxënësve, bazuar në parime, standarde dhe strategji të avancuara të vlerësimit;

---

<sup>1</sup>Më gjerësisht, shih: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2017). Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë.

<https://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/04/kornize-strategjike.pdf>



- ofrimin e informatave kthyesë për nxënës;
- mbështetjen e të nxënësve të nxënësve;
- interpretimin e të dhënave për të përmirësuar nxënien,
- shfrytëzimin e të dhënave për përmirësimin e procesit të mësimdhënies;
- dokumentimin e dëshmive që mbështesin procesin e vlerësimit të nxënësve;
- raportimin për prindër dhe institucionet që kanë përgjegjësi sa i përket arritjeve të nxënësve;

Korniza e Vlerësimit të Nxënësve, me qëllim që të sigurojë mbështetjen e të nxënësve të nxënësve dhe cilësinë e vlerësimeve të nxënësve nga ana e mësimdhënësve, i mbështet dhe promovon treguesit për kompetenca të mësimdhënësve në fushën e vlerësimit të nxënësve dhe kërkesat për arritjen e tyre.

#### **4.4. Ndërtimi i kapaciteteve të mësimdhënësve për vlerësimin e nxënësve**

Sistemi i licencimit të mësimdhënësve në Kosovë, krahas kërkesave dhe treguesve për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, përcakton edhe kërkesat për zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve (ZHPM). Kushtet/kërkesat për zhvillim profesional të mësimdhënësve për licencë të karrierës të përcaktuara në dokumentin Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë (2017), fokusohen në:

- zotërimin e lëndës;
- zgjerimin e repertorit të shkathtësive pedagogjike;
- vlerësimin e nxënësve dhe përshtatjen e mësimdhënies sipas rezultateve të vlerësimit;
- motivimin e nxënësve;
- punën me ekipet/aktivat profesionale;
- punën me prindër, etj..

Korniza parasheh që ndërtimi i kapaciteteve të mësimdhënësve në fushën e vlerësimit të nxënësve të bëhet në koordinim midis DSCSVL dhe Divizionit për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve. Gjithashtu, Korniza parasheh që formulimi i drejtimeve për ndërtimin e kapaciteteve të mësimdhënësve në fushën e vlerësimit të nxënësve të bëhet në bazë të analizave të rezultateve të nxënësve në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të nevojave të mësimdhënësve për zhvillim profesional në këtë fushë.

#### **4.5. Përdorimi i rezultateve të vlerësimit të nxënësve në punën me mësimdhënës**

Rezultatet nga vlerësimet e nxënësve nuk duhet të përdoren për vlerësim përmblendës të performancës së mësimdhënësve, në këtë raport ato duhet të funksionojnë si prova "rrethore" për vlerësimin e mësimdhënësve. Pra, ato duhet të përdoren vetëm për vlerësim formativ të mësimdhënësve. Sepse, ka argumente të vërtetuara se që në rezultatet e nxënësve, (në Vlerësimin në nivel shkolle, Vlerësimet kombëtare apo ndërkombëtare) ndikojnë edhe shumë faktorë të tjerë, si për shembull përkushtimi dhe angazhimi i vetë nxënësve për mësim të pavarur, puna shtesë e prindërve dhe e familjes, përfshirja e nxënësve në kurse dhe aktivitete që organizohen nga OJQ dhe institucione të tjera jashtë shkolle, si dhe faktorë të tjerë të kontekstit.

Në një kuptim më formal, rezultatet mund të jenë të dobishme për t'u ndihmuar mësimdhënësve që të bëhen mësimdhënës më të mirë. Nëse krahasohen me mësimdhënës të tjerë brenda të së njëjtës shkollë, dhënia e të njëjtave lëndë për të njëjtën klasë të nxënësve, variacionet e mëdha në rezultate mund të jenë indikative që mësimi i tyre mund të përmirësohet. Sidoqoftë, kjo duhet të jetë një pikë fillestare për ta ndihmuar mësimdhënësin në përmirësim, në vend të gjyqimit të cilësisë së tij ose të saj në mësimdhënie.

Jo vetëm dallimet ndërmjet mësimdhënësve, por edhe dallimet brenda mësimdhënësve mund të jenë të dobishme për përmirësimin e arsimit. Profile të ndryshme në rezultate mund të gjenden në performanca në klasë në një pjesë të veçantë të kurrikulës. Kjo do të thotë që në një grup të veçantë të lëndëve performanca e klasës është nën nivelin që pritet duke pasur parasysh rezultatet në lëndët e tjera dhe duke pasur parasysh vështirësinë e grupit të lëndëve. Në atë rast, ky informacion mund të jetë shumë i vlefshëm për mësimdhënësin, pasi ai ose ajo e kupton se kjo pjesë e veçantë e kurrikulës mund të kërkojë vëmendje më të madhe. Përsëri, qëllimi këtu është ta ndihmojmë mësimdhënësin, dhe jo ta gjykojmë atë.

Aspekti më i rëndësishëm i përdorimit të rezultateve të vlerësimeve të nxënësve, në raport me punën me mësimdhënës, është përdorimi i tyre si burim për:

- informimin e mësimdhënësve për shkallën e arritjes së nxënësve, vështirësitë e theksuara në pjesë të caktuara të kurrikulës/programit dhe kompetencave të nxënësve, me qëllim që mësimdhënësi/it të kenë vëmendje më të madhe gjatë punës me nxënës;
- vlerësim formativ të mësimdhënësve nga ana e udhëheqësve të shkollave dhe e mekanizmave të tjerë që merren me zhvillimin e mësimdhënësve;
- inicim të analizave më të thelluara për praktikën e mësimdhënies, komunikimin ndërveprues ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve, ndikimin e përdorimit të materialeve dhe të burimeve shtesë nga mësimdhënësit, ndikimin e formave të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në rezultatet e nxënësve;
- ofrimin e mundësisë së përfshirjes së mësimdhënësve në trajnime dhe në forma të tjera të zhvillimit profesional të vazhdueshëm në fushën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të nxënësve;
- zhvillimin e programeve të aftësisë dhe të materialeve e të udhëzuesve profesionalë për mësimdhënës.

Kjo nënkupton që, në praktikën e përdorimit të rezultateve të vlerësimeve të nxënësve, në raport me mësimdhënës, theksi duhet të vendoset në informimin e mësimdhënësve për rezultatet në vlerësim të nxënësve të tyre, në vlerësim formativ të mësimdhënësve, në analiza për efektin që kanë pasur masat e aplikuara nga mësimdhënësit/et për përmirësimin e trendit të performancës së tyre dhe ndikimin në rezultatet e nxënësve, si dhe në përkrahje të mësimdhënësve për zhvillim dhe avancim profesional të vazhdueshëm.

#### **4.6. Dokumentet relevante**

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008): Ligji nr. 03 / L-068 Për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011): Ligji nr. 04 / L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (9 shtator 2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2016): Ligji nr. 05/l-066 Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 38 / 21 Nëntor 2016, Prishtinë.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2018): Ligji nr. 06 / L-046 Për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2017). Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë.
6. Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM, 2012): Manual për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve - Kriteret, Procedurat dhe Instrumentet. (Draft).
7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2017). Udhëzimi Administrativ nr. 6/2017 Për Kriteret dhe Procedurat e Aprovimit të Programeve për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Punëtorëve Arsimorë.
8. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2017). Udhëzimi Administrativ nr. 5/2017 Për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimin e Mësuesve në Karrierë.
9. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Kosovës (2018). Udhëzimi Administrativ (14/2018) Për Vlerësim të Performancës së Mësimdhënësve.
10. MASH & GIZ (2015). Vlerësimi përmbljedhës dhe hartimi i testit si pjesë e rëndësishme e tij për klasat 1-9 - Doracak për mësimdhënësit.

## KAPITULLI V – ASPEKTE TË VLERËSIMIT TË SHKOLLËS NË NDËRLIDHJE ME VLERËSIMIN E NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve realizohet në shkollë dhe luan një rol të caktuar për vlerësimin e shkollës. Prandaj, në këtë kapitull përshkruhet shkurtimisht sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës, aspektet e vlerësimit të performancës së shkollës në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve, roli i shkollës për vlerësimin e nxënësve dhe sigurimin e cilësisë së vlerësimit të nxënësve, si dhe parashikimet për rolin e vlerësimit të nxënësve për të bërë vlerësimin e shkollës.

### 5.1. Sistemi i vlerësimit të performancës së institucionit arsimor/shkollës

Vlerësimi i performancës së shkollës shihet si një element i rëndësishëm i sistemit të sigurimit të cilësisë në arsim në Kosovë. Sistemi ynë i vlerësimit të performancës së shkollës përbëhet nga Vlerësimi i brendshëm (vetëvlerësimi i shkollës) dhe Vlerësimi i jashtëm<sup>1</sup>. Dokumenti Kornizë i Sigurimit të Cilësisë së Performancës së Shkollës në Kosovë (MASH & IPK, 2016), është referencë kryesore për sistemin e sigurimit të cilësisë në Arsimin parauniversitar dhe standardizimin e procesit të Vlerësimit të brendshëm dhe të Vlerësimit të jashtëm të shkollës, planifikimin zhvillimor të shkollës (PZHSH) dhe planin vjetor të veprimit. Sistemi është i ndërtuar në ndërlidhje me parimet e kurrikulës, në mënyrë që të sigurohet koherencë dhe konsistencë në procesin e zbatimit të Kurrikulës së bazuar në kompetenca, sipas të cilës vlerësimi i nxënësve është një komponentë thelbësore e reformës kurrikulare.

### 5.2. Aspekte të vlerësimit të performancës së shkollës në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve

Aspektet kryesore për vlerësimin e performancës së shkollës janë: fushat e cilësisë së institucionit arsimor (aspekti vertikal i cilësisë së shkollës), kriteret e cilësisë, që e përshkruajnë pritjen bazike që duhet të arrihet (shtrirja), dhe treguesit e performancës së shkollës (thellësia e vlerësimit). Të gjitha këto aspekte janë të ndërlidhura me vlerësimin e nxënësve. Ndërlidhja sigurohet në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes fushës së cilësisë – performancës së nxënësve<sup>2</sup>, e cila në dokumentin e kornizës për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë ka këtë përshkrim:

*Performanca e nxënësve është fusha thelbësore për vlerësimin e performancës së shkollës, pasi që pasqyron efektivitetin e shkollës në realizimin e misionit thelbësor të saj. Vlerësimi i performancës së shkollës, në kuadër të kësaj fushe, do të përqendrohet në nivelin e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset e shkollës, si formë e manifestimit të kompetencës për të ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në kuadër të shkollës, nivelin dhe cilësinë e pjesëmarrjes në aktivitetet ekstra-kurrikulare në shkollë dhe jashtë saj, nivelin e zotërimit të kompetencave kryesore, nivelin e arritshmërisë së rezultateve sipas fushave kurrikulare, arritshmëritë nga kurrikula - me zgjedhje dhe angazhimin e tyre për menaxhimin e përparimit vetanak. Performanca e nxënësve manifestohet përmes veprimtarive që nxënësit i ndërmarrin në shkollë, rezultateve të nxënësve në vlerësimet e brendshme dhe të jashtme, projekteve të realizuara nga nxënësit, përfaqësimit dhe suksesit të nxënësve në gara të ndryshme të dijes e të shkathtësive në nivel të shkollës, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe përfshirjes me sukses të nxënësve në nivele të tjera të shkollimit.*

<sup>1</sup> Më gjerësisht, shih: Udhëzimi Administrativ nr. 04/2017: Vlerësimi i Performancës në Institucionet e Arsimore. Prishtinë. <http://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/08/4-2017-ua-vleresimin-e-performances-se-institucioneve-arsimore-ne-arsimin-parauniversitar-rotated.pdf>

<sup>2</sup> Fushat e tjera të cilësisë, janë: Menaxhmenti dhe qeverisja; Kultura dhe mjedisi shkollor; Mësimdhënia dhe të mësuarit; Zhvillimi profesional i mësimdhënësit.

Nga ky përshkrim, mund të shihet qartë se aspektet e vlerësimit të performancës së shkollës janë të lidhura edhe me vlerësimin e nxënësve, me atë se si e manifeston shkolla performancën e saj në vlerësimin dhe arritjet e nxënësve në nivel shkolle, por edhe në vlerësimet në nivel lokal, kombëtar dhe në nivel ndërkombëtar. Rezultatet e vlerësimit të nxënësve shkollës i shërbejnë për Vlerësim formativ të performancës së shkollës, për krijimin e kriterëve të cilësisë, që lidhen me punën me nxënës dhe për të orientuar fokusin e zhvillimit të saj.

Ndërlidhja dhe rëndësia e performancës së nxënësve nënvizohet edhe me faktin se akti nënligjor (UA nr. 04/2017) rregullon Sistemin e vlerësimit të performancës së shkollës. Performanca e nxënësve është fusha e cilësisë që duhet të jetë subjekt i secilit vetë-vlerësim të shkollës, me qëllim që shkolla të përmbush funksionin e saj, që është avancimi i nivelit të arritshmërisë së nxënësve, dhe të sigurojë që nxënësit të përfitojnë zhvillim maksimal nga shkolla.

### **5.3. Roli i shkollës në vlerësimin e nxënësve dhe në sigurimin e cilësisë së vlerësimit të nxënësve**

Roli i shkollës në vlerësimin e nxënësve është i përshkruar në dokumentet kurrikulare (2016) dhe dokumentet që përcaktojnë dhe rregullojnë Vlerësimin e brendshëm të nxënësve, Vlerësimin për shkallë kurrikulare dhe Vlerësimet e standardizuara shtetërore në fund të niveleve të arsimit parauniversitar (2016).

- Në Vlerësimin e brendshëm të nxënësve, i cili organizohet nga mësimmshënësist dhe aktivitetet profesionale, roli i shkollës në vlerësimin e nxënësve është mbështetës, promovues dhe informues për të realizuar vlerësim të nxënësve bazuar në kriteret dhe në parimet e kodit etik për vlerësimin e nxënësve.
- Në Vlerësimin e nxënësve për shkallë kurrikulare, roli i shkollës është udhëheqës, koordinues dhe mbikëqyrës për të siguruar vlerësim real që mundëson identifikimin e nevojave për mbështetje të nxënësve në zotërim të kompetencave dhe rezultateve të të nxënësve.
- Në vlerësimet e standardizuara shtetërore në fund të niveleve të Arsimit parauniversitar, roli i shkollës është që të sigurojë përgatitje të duhura, informim të plotë të nxënësve dhe të komunitetit të shkollës për qëllimet e vlerësimit dhe për praktikën e përdorimit të rezultateve, si dhe menaxhim të bazuar në kriteret që sigurojnë besueshmëri të lartë të vlerësimeve. Roli i njëjtë i shkollës reflektohet edhe në hulumtimet ndërkombëtare, si: PISA, TIMSS, etj..

Shkolla, për ta përmbushur rolin e saj në vlerësimin e nxënësve dhe në sigurimin e cilësisë së vlerësimit të nxënësve, duhet të angazhohet maksimalisht në përmbushjen e kriterëve të cilësisë dhe të treguesve të performancës së shkollës, që janë të përcaktuar me Dokumentin Kornizë për Sigurimin e Cilësisë së Performancës së Shkollës në Kosovë.

Korniza e Vlerësimit të Nxënësve, me qëllim që të sigurojë mbështetjen e shkollës për përmirësimin e rezultateve të saj në punën me nxënës, i mbështet dhe i promovon kërkesat për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës, në mënyrë të veçantë kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës, që kanë ndërlidhje të drejtpërdrejta me vlerësimin e nxënësve. Për këtë qëllim, këta tregues janë integruar edhe në Dokumentin Kornizës të Vlerësimit të Nxënësve, siç pasqyrohen në Tabelën në vijim.

**Tabela 11. Treguesit për vlerësimin e shkollës në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve**

<b>Treguesit për vlerësimin e shkollës në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve:</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Vlerësimi i arritshmërisë së nxënësve për zotërimin e kompetencave në fund të shkollëve kurrikulare, administrohet në mënyrë efektive dhe bazohet në evidenca;</li><li>▪ Analiza e rezultateve të arritshmërisë së nxënësve për zotërimin e kompetencave kryesore shfrytëzohet për identifikimin e faktorëve që pengojnë arritshmërinë e nxënësve dhe planifikimin e masave për evitimin e tyre;</li><li>▪ Shkolla ka ndërtuar një sistem efektiv të administrimit të rezultateve të arritshmërisë së nxënësve - në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare;</li><li>▪ Vlerësimi për të nxënë bëhet me metoda adekuate për inkurajimin dhe motivimin e vazhdueshëm të nxënësve në nxënie;</li><li>▪ Vlerësimi i të nxënit (notimi) është transparent, korrekt dhe ndihmues për nxënësit;</li><li>▪ Rezultatet e vlerësimit të nxënësve dhe informatat kthyesë të nxënësve shfrytëzohen për të planifikuar dhe përshtatur proceset mësimore në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve;</li><li>▪ Niveli i zotërimit të rezultateve të kompetencave për shkollë kurrikulare plotësojnë pritshmërinë e vendosur në Kurrikula Bërthamë;</li><li>▪ Niveli i arritshmërisë së nxënësve për zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fusha kurrikulare, plotëson pritshmërinë e vendosur në Kurrikula Bërthamë.</li></ul>

Duke iu referuar këtyre treguesve dhe treguesve të tjerë të performancës së shkollës, për një performancë efektive dhe cilësore të shkollës, përveç të tjerash, shkolla duhet të ketë agjendë të qartë dhe përkushtim për përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të saj, në të mirë të përkrahjes së nxënësve për zotërimin e kompetencave kryesore dhe realizimin e potencialit të tyre. Gjithashtu, kërkohet qasje vetëkritike për rezultatet e nxënësve si në Vlerësimin e brendshëm, ashtu edhe në Vlerësimin kombëtar dhe ndërkombëtar, në mënyrë që të përqafohet cikli i përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shkollës edhe në fushën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të nxënësve. Vetëm kështu reflektohet ndikimi i vlerësimit të performancës së shkollës në vlerësimin e nxënësve dhe anasjelltas - rezultatet e vlerësimit të nxënësve reflektojnë në cilësinë e performancës së shkollës.

#### **5.4. Drejtimitet e ardhshme - për rolin e vlerësimit të nxënësve në vlerësimin e shkollës**

Qasja e sistemit për vlerësimin e shkollës në Kosovë është zhvillimore dhe i shërben planifikimit zhvillimor të shkollës, planifikimit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, planifikimit të resurseve të nevojshme, riorganizimit të punës në shkollë, etj., me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore dhe të zhvillimit të përgjithshëm të shkollës. Në këtë frymë është përshkruar edhe përdorimi i rezultateve të vlerësimit të nxënësve në vlerësimin e performancës së shkollës, frymë e cila i referohet vlerësimit formativ të shkollës.

Për vlerësim formativ të shkollës, në raport me përdorimin e drejtë të rezultateve të nxënësve nga vlerësimet e ndryshme, (në nivel të shkollës - Vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare) në funksion të përmbushjes së rolit të shkollës në vlerësimin e nxënësve dhe në sigurimin e cilësisë së vlerësimit të nxënësve, shkolla në procesin e vetëvlerësimit në këtë fushë, duhet t'u përgjigjet disa pyetjeve, si në vijim:

**Tabela 12. Pyetjet orientuese të analizës së praktikave dhe të proceseve të vlerësimit të nxënësve – për vlerësim të shkollës, në lidhje me vlerësimin e nxënësve<sup>1</sup>**

Pyetjet orientuese të analizës së praktikave dhe të proceseve të vlerësimit të nxënësve – për vlerësim të shkollës, në lidhje me vlerësimin e nxënësve
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Si analizohen rezultatet e arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare? A identifikohen, me këtë rast, faktorët që kanë penguar arritshmërinë e nxënësve dhe masat e nevojshme për adresimin e këtyre faktorëve? Kush i bën këto analiza? Mbi çka bazohen ato? A ka shkolla evidenca të këtyre analizave?</li> <li>▪ A shfrytëzohet vlerësimi për inkurajimin dhe motivimin e nxënësve për nxënie?</li> <li>▪ A është vlerësimi i të nxënësve transparent dhe korrekt? A janë nxënësit në dijeni për notat e tyre? A pajtohen me vlerësimin e bërë nga mësuesit? Cilat janë shqetësimet e tyre në lidhje me këtë proces?</li> <li>▪ A shfrytëzohet vlerësimi formativ për përkrahjen e nxënësve në planifikimin e të nxënësve të tyre? A shfrytëzohet për identifikimin dhe adresimin e nevojave të ndryshme të nxënësve me rastin e planifikimit të procesit mësimor?</li> <li>▪ A shfrytëzohet vlerësimi për shkallë kurrikulare për rishikimin dhe freskimin e kurrikulës me zgjedhje? Si është dokumentuar ky proces?</li> <li>▪ Cili është niveli i performancës së nxënësve në zotërimin e rezultateve të kompetencave kryesore në fund të shkollës kurrikulare? Çfarë është trendi i arritshmërisë?</li> <li>▪ Si realizohet procesi i vlerësimit të arritshmërisë së kompetencave kryesore në fund të shkollës kurrikulare? A është vlerësimi i besueshëm dhe relevant?</li> <li>▪ Cili është niveli i performancës së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për lëndë mësimore dhe fushat kurrikulare? Çfarë është trendi i arritshmërisë?</li> <li>▪ A vlerësohet cilësia e mësimit dhe format e përkrahjes së nxënësve nga perspektiva e efikasitetit në ngritjen e arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare? Nga kush bëhen këto vlerësime? A janë të evidentuara ato?</li> </ul>

Korniza e Vlerësimit të Nxënësve parasheh që këto pyetje dhe pyetje të tjera, të cilat shtrohen sipas nevojës për vlerësimin e nxënësve, të jenë bazë për Vlerësim formativ të shkollës, për të përcaktuar drejtimit e ardhshme të shkollës në funksion të përmbushjes së rolit të saj në sigurimin e cilësisë së vlerësimit të nxënësve dhe, përgjithësisht, në funksion të përmirësimit të rezultateve të shkollës.

#### **5.4.1. Ndërtimi i kapaciteteve për vlerësimin e shkollës në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve**

Sistemi i vlerësimit të shkollës kërkon kapacitete të brendshme në nivel shkolle dhe kapacitete të vlerësuesve të jashtëm, por edhe kapacitete të komunave që të ofrojnë shërbime mbështetëse për shkollat dhe inspektoratin e arsimit, në zbatimin e këtij sistemi dhe në funksion të zhvillimit të shkollës.

<sup>1</sup> Pyetjet i referohen Udhëzuesit për Vlerësimin e brendshëm të shkollës (IPK, 2016b).

Korniza e Vlerësimit të Nxënësve parasheh që ndërtimi i kapaciteteve për vlerësimin e shkollës në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve, duhet të fokusohet në:

- Udhëheqjen e procesit të vetëvlerësimit dhe të Vlerësimit të jashtëm;
- Përdorimin e rezultateve të Vlerësimit të brendshëm të nxënësve për Vlerësim formativ të shkollës;
- Zhvillimin e planeve për përmirësim të shkollë, që kanë për objektiv përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe sigurimin e cilësisë së vlerësimeve të nxënësve;
- Raportimin e drejtë dhe me kohë të proceseve dhe të rezultateve të vlerësimeve etj..

#### **5.4.2. Përdorimi i rezultateve të vlerësimit të nxënësve për Vlerësim formativ të performancës së shkollës**

Ashtu si për mësimdhënës, rezultatet nga vlerësimet e nxënësve nuk duhet të përdoren për Vlerësim përmbledhës të performancës së shkollës. Në këtë raport, edhe për këtë qëllim të vlerësimit, duhet të funksionojnë si prova "rrethore" për vlerësimin e punës së shkollë. Pra, ato duhet të përdoren vetëm për Vlerësim formativ të shkollës, për faktin se sistemi ynë i Vlerësimit të performancës së shkollës ka përcaktuar një qasje zhvillimore.

Ekziston një arsye tjetër e rëndësishme për të mos i përdorur vlerësimet e nxënësve si një Vlerësim përmbledhës i shkollave dhe i mësimdhënësve. Nëse shkollat dhe mësimdhënësit vlerësohen bazuar në rezultatet e nxënësve, ata përfitojnë nga MASHrimi. Këto mund të jenë forma të MASHrimit, (për shembull, duke i ndryshuar përgjigjet e pasakta në ato të sakta) por, gjithashtu, mund të jenë forma pak më delikate, siç është neglizhimi - nëse shohin se nxënësit po MASHrojnë. Kjo nuk është me të vërtetë e dobishme për nxënësit, për shkollën dhe sigurisht as për arsimin në përgjithësi.

Qasja zhvillimore e sistemit tonë të vlerësimit të performancës së shkollës, të cilën e promovon edhe Korniza e Vlerësimit të Nxënësve, kërkon që rezultatet e vlerësimeve të nxënësve, duhet të përdoren si burim për:

- informimin e komunitetit të shkollës për shkollën e arritjes së nxënësve, vështirësitë e theksuara në pjesë të caktuara të kurrikulës/programit dhe të kompetencave të nxënësve;
- inicimin e analizave më të thelluara në nivel shkollë, për praktikën e mësimdhënies, cilësinë e shërbimeve që ofrohen nga shkolla, ndikimin e përdorimit të materialeve dhe të burimeve shtesë nga mësimdhënësit, ndikimin e formave të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në rezultatet e nxënësve;
- vlerësimin formativ të shkollës nga ana e ekipit për vetëvlerësim të shkollës, sipas parimeve: pjesëmarrja, transparenca, objektiviteti dhe saktësia;
- zhvillimin e programeve të aftësisë dhe të materialeve e udhëzuesve profesionalë për shkolla dhe ekipet e vetëvlerësimit të shkollës.

Rezultatet e nxënësve mund të jenë të dobishme për t'i ndihmuar shkollat që të bëhen më të mira në ofrimin e shërbimeve të tyre në mësimdhënie dhe në forma të tjera të punës me nxënës. Ato duhet të jenë një pikë fillestare për ta ndihmuar shkollën në përmirësimin e performancës së saj në vend të gjyqimit të cilësisë së saj. Ndryshimet brenda shkollës mund të jenë të dobishme për përmirësimin e



arsimit, për këtë arsye është vendosur që qasja e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës të jetë zhvillimore.

Gjithsesi, rezultatet nga vlerësimet e nxënësve mund të përdoren për të iniciuar analiza më të thelluara për cilësinë e sistemit arsimor.

### 5.5. Dokumentet relevante

1. Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016a). Instrumenti për vlerësimin e performancës së shkollës. Prishtinë.  
<http://ipkMASH.rks-gov.net/instrumenti-per-vleresimin-e-performances-se-shkolles/>
2. Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016b). Udhëzues për vlerësimin e brendshëm të shkollës (Fushat e cilësisë – Kriteret – Treguesit). IPK, Prishtinë.  
<http://ipkMASH.rks-gov.net/udhezuesi-per-vleresimin-e-brendshem-te-shkolles/>
3. Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016c). Udhëzues për vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës. IPK, Prishtinë.  
<http://ipkMASH.rks-gov.net/udhezuesi-per-vleresimin-e-jashtem-te-shkolles/>
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2018): Ligji nr. 06 / L-046 Për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-068 (2008), Prishtinë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës  
[http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L068\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L068_al.pdf)
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 04/L-032 (2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës  
<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20arsimin%20parauniversitar.pdf>
7. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë. IPK, Prishtinë.  
<http://ipkMASH.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-se-shkolles/>
8. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (04/2017). Udhëzimi Administrativ nr. 04/2017: Vlerësimi i performancës në Institucionet e Arsimore. Prishtinë.  
<http://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/08/4-2017-ua-vleresimin-e-performances-se-institucioneve-arsimore-ne-arsimin-parauniversitar-rotated.pdf>
9. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2015). Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020. Prishtinë.  
<http://MASH.rks-gov.net/uploads/2016/12/qa-strategy-final-shqip.pdf>
10. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016c). Udhëzimi Administrativ nr. 24/2016: Sigurimi i Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Prishtinë.  
<http://MASH.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf180.pdf>

11. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016d). Udhëzimi Administrativ nr. 23/2016 për Planin Zhvillimor të Shkollës dhe Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit. Prishtinë.  
<http://MASH.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf90.pdf>
12. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016e). Udhëzimi Administrativ nr. 22/2016 për Aktivitet Profesional (Departamentet) të Shkollave. Prishtinë.  
<http://MASH.rks-gov.net/uploads/2016/12/22-ua-nr-22-2016-per-aktivitetet-profesionale-te-shkollave.pdf>
13. Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2012). Udhëzimi Administrativ nr. 04/2012: Standardet e Praktikës Profesionale të Drejtorëve të Shkollës. Shkarkuar më: 21.10. 2017.  
[http://www.MASH-gov.net/advCms/documents/udhezim\\_administrativ\\_04\\_2012\\_shqip.pdf](http://www.MASH-gov.net/advCms/documents/udhezim_administrativ_04_2012_shqip.pdf)

## **KAPITULLI VI - VLERËSIMI I SISTEMIT DHE ROLI I VLERËSIMIT TË NXËNËSVE**

Vlerësimi i sistemit mbështetet në mekanizmin vjetor dhe periodik të vlerësimit për cilësinë dhe efektshmërinë e sistemit arsimor, rishikimin dhe reformim e tij. Vlerësimi i nxënësve ka rol të veçantë në vlerësimin e sistemit. Prandaj, në këtë kapitull, fillimisht paraqiten karakteristikat e përgjithshme të vlerësimit të sistemit, si dhe mekanizmat dhe kompetencat për vlerësimin e sistemit të arsimit. Më pas kapitulli ka një përqendrim në aspektet e vlerësimit të sistemit, ndërtimin e kapaciteteve për të vlerësuar sistemin, procedurat dhe instrumentet për të vlerësuar sistemin, iniciativat dhe zbatimin e tyre, si dhe për përdorimin e rezultateve të vlerësimit për hartimin e politikave.

### **6.1. Karakteristikat e përgjithshme të vlerësimit në Arsimit parauniversitar**

Me qëllim që sigurohet një ndërlidhje midis dokumenteve që rregullojnë përgjegjësitë në vlerësimin e sistemit dhe rolin të vlerësimit të nxënësve e të drejtimeve të ardhshme për vlerësimin e sistemit, si dhe rolin e vlerësimit të nxënësve në këtë proces, në këtë kapitull fillimisht pasqyrohet një përmbledhje e karakteristikave të përgjithshme të vlerësimit të nxënësve, pastaj përvijohen drejtimit e ardhshme për vlerësimin e sistemit.

#### **6.1.1. Korniza ligjore**

Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës (2008)<sup>1</sup> dhe Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011)<sup>2</sup>, ndër të tjera kanë përcaktuar organizimin e Arsimit parauniversitar dhe kanë përcaktuar përgjegjësitë MASH-it dhe të agjencive arsimore, të Komunave, dhe Institucioneve arsimore. Bazuar në këto ligje, MASH ka për detyrë që të promovojë dhe të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit dhe të aftësisë përmes mekanizmave të MASH-it për inspektim, monitorim, dhe vlerësim, si dhe të organizojë dhe të menaxhojë Vlerësimin e jashtëm për nivelet 1, 2 dhe 3 të ISCED-it.

Me Ligjin e ri për Inspektoratin e Arsimit (2018)<sup>3</sup>, Inspektorati i Arsimit merr rol të veçantë në komponentin e inspektimit pedagogjik dhe bëhet organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë në arsim. Në nivel të institucioneve arsimore, sigurimi i cilësisë rregullohet me Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, i miratuar në vitin 2011 dhe me Udhëzimin Administrativ 24/2016 për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar në Kosovë.

Korniza Legjislative për Arsimin në Kosovë, krahas legjislacionit primar, është e plotësuar edhe me Udhëzime administrative<sup>4</sup>, Rregullore të MASH-it<sup>5</sup> dhe Dokumente strategjike<sup>6</sup>. Mirëpo, nuk ka një dokument të vetëm që përcakton qartë mënyrën e vlerësimit të Sistemit arsimor parauniversitar, rolin

---

<sup>1</sup>Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-068 (2008), Prishtinë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

[http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L068\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L068_al.pdf)

<sup>2</sup>Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 04/L-032. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17 / 16 Shtator 2011, Prishtinë.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

<sup>3</sup>Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 13 / 10 Gusht 2018, Prishtinë. [https://gzk.rks-](https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=17744)

[gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=17744](https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=17744)

<sup>4</sup><https://MASH.rks-gov.net/udhezimet-administrative>

<sup>5</sup><https://MASH.rks-gov.net/rregulloret>

<sup>6</sup><https://MASH.rks-gov.net/strategjite>

që duhet të ketë vlerësimi i nxënësve, format e raportimit dhe të shfrytëzimit të gjetjeve dhe të rezultateve. Segmente të veçanta të vlerësimit të sistemit arsimor, janë të përshkruara në dokumente të ndryshme, të cilave iu kemi referuar në kapitujt e këtij dokumenti.

### **6.1.2. Roli i vlerësimit të nxënësve në vlerësimin e sistemit**

Vlerësimi i sistemit përmes vlerësimit të nxënësve është praktikë që aplikohet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në varësi të qëllimeve për vlerësimin e nxënësve, mund të sigurohen evidenca dhe raporte të rezultateve që pasqyrojnë gjendjen dhe cilësinë e arsimit në nivele të ndryshme të tij (në Arsimin fillor, Arsimin e mesëm të ulët dhe Arsimin e mesëm të lartë).

Praktikat aktuale të vlerësimit të sistemit përmes vlerësimit të nxënësve janë të ndërlidhura me vlerësimet e jashtme që organizohen nga MASH përmes DSCSVL (vlerësimi i klasës së 5-të, vlerësimi i klasës së 9-të dhe Provimi i Maturës dhe vlerësimet ndërkombëtare, si: PISA, TIMSS dhe PIRLS.

Përkundër përvojës së fituar ndër vite me vlerësimet kombëtare, praktikat aktuale tregojnë se vlerësimi i përgjithshëm i sistemit nuk është i lidhur sistematikisht me vlerësimin e nxënësve dhe nuk ka një praktikë të konsoliduar mirë për shfrytëzimin e rezultateve për politikë-bërje arsimore. Për të gjitha vlerësimet e nxënësve që organizohen në Kosovë, përgatitja e raporteve është e detyrueshme, mirëpo përmbajtja dhe formati i tyre nuk janë përcaktuara qartë dhe kjo ka bërë që praktikat aktuale të përgatitjes së raporteve për vlerësimet kombëtare të nxënësve më shumë të bëhet për qëllime të brendshme.

Fillimi i pjesëmarrjes së Kosovës në vlerësimet ndërkombëtare shihet si një mundësi e mirë për vlerësimin e sistemit të arsimit dhe të përgatitjes së raporteve të rezultateve për politikë-bërje arsimore. Kosova ka marrë pjesë në hulumtimet PISA (2015 dhe 2018) dhe TIMSS (2019). Rezultatet e nxënësve dhe raportet në hulumtime të tilla ndërkombëtare, kryesisht shërbejnë për të informuar sistemet kombëtare të arsimit me nivelin e kompetencave të nxënësve në fushat kyçe që janë objekt i vlerësimit, (Lexim, Matematikë, Shkencat të natyrës, etj.) si dhe ofrojnë mundësi të krahasimit të trendëve me vendet e rajonit, vendet e OECD-së dhe me të gjitha vendet pjesëmarrëse. Rezultatet, përkatësisht raportet kombëtare ofrojnë mundësi që secila shkollë të përdorë të dhënat nga hulumtime të tilla apo hulumtime të tjera të ngjashme, për qëllime të brendshme, analiza dhe krahasime.

### **6.1.3. Baza e të dhënave të lidhura me vlerësimin e sistemit**

Raporti vjetor statistikor me tregues arsimorë, raportet e tjera statistikore nga SMIA dhe Raporti vjetor për vlerësimin e zbatimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë janë raporte kombëtare që publikohen rregullisht për sistemin arsimor në Kosovë. Këto raporte shërbejnë si bazë për zhvillimin e politikave arsimore, përmbushin mandatin për të siguruar të dhëna dhe për të vlerësuar pjesëmarrjen në arsim, cilësinë e shërbimeve në sistemin arsimor të Kosovës, si dhe arritjet e nxënësve dhe studentëve në Kosovë.

Raportet vjetore statistikore publikohen nga SMIA në faqen zyrtare të MASH-it <https://MASH.rks-gov.net/statistikat>. Ato janë të hapura për përdorim nga të gjithë hisedarët e arsimit dhe të interesuarit e tjerë që merren me vlerësimin e arsimit dhe zhvillimin e politikave e të programeve arsimore.

Statistikat e arsimit që grumbullohen nga SMIA mbulojnë të gjitha nivelet e arsimit: institucionet e arsimit Parashkollor, Fillor dhe të Mesëm të Ulët, të Mesëm të Lartë, (Gjimnazet) si dhe të Arsimit profesional, arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta, arsimit privat, arsimit dhe aftësimin për të rritur, arsimit universitar, kolegjeve private; gjithashtu mbulojnë kushtet e mësimnxënies, ndryshimet sipas

niveleve, si dhe informacione për statusin social dhe familjar të nxënësve. Të dhënat e arsimit mbulojnë sektorin publik dhe sektorin privat, me përjashtim të disa shkollave serbe, të cilat nuk raportojnë në SMIA.

Publikimi i statistikave që lidhet me fëmijë/nxënës/studentë dhe personelin arsimor, përmbajnë të dhëna për:

- numrin e fëmijëve në arsimin Parashkollor dhe Parafillor, sipas komunave, grup-moshave, gjinisë, nacionalitetit dhe personelin edukativo-arsimor;
- numrin e nxënësve në arsimin Fillor dhe të Mesëm të Ulët, sipas komunave, klasave, gjinisë, nacionalitetit dhe personelin arsimor;
- numrin e nxënësve në Arsimin e Mesëm të Lartë, sipas komunave, klasave, gjinisë, nacionalitetit, sipas shkollave profesionale – gjimnazeve, dhe sipas personelin arsimor;
- numrin e nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla dhe Qendrat burimore, sipas gjinisë, klasave dhe sipas llojeve të dëmtimit – vështirësive, dhe sipas personelin arsimor;
- numrin e nxënësve në arsimin privat, sipas niveleve të Arsimit parauniversitar, sipas komunave, klasave, gjinisë, nacionalitetit dhe sipas personelin arsimor;
- numrin e studentëve në Arsimin universitar, sipas gjinisë, sipas nacionalitetit, fakulteteve e programeve të studimit, sipas niveleve bachelor dhe master, numrit të të diplomuarve në bachelor dhe master dhe sipas stafit akademik, etj..

Në anën tjetër, në raportet e viteve të fundit për vlerësimin e PSAK-ut 2017-2021, krahas vlerësimit të objektivave strategjike, të masave dhe të aktiviteteve të realizuara sipas viteve të planit të veprimit, është bërë praktikë që të bëhet edhe një analizë e kontekstit të vlerësimit, përfshirë kontekstin politik, ekonomik, social, teknologjik, fushat e planit strategjik, objektivat, si dhe krahasime me tregues statistikorë dhe arritje në arsim - me vendet e OECD-s dhe me vende të rajonit.

Korniza parasheh që statistikat zyrtare për arsim të jenë bazë e planifikimeve për vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me vlerësimin e sistemit arsimor, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohen mostra përfaqësuese që sigurojnë mbulueshmëri të të gjitha karakteristikave demografike dhe shoqërore.

#### **6.1.4. Mekanizmat dhe kompetencat e vlerësimit të sistemit**

Përshkrimi i mekanizmave të sistemit, në këtë kapitull, i referohet rolit të tyre në vlerësimin e sistemit. MASH dhe mekanizmat e saj, siç janë Divizioni për Sigurimin e Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim (DSCSVL), Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), Inspektorati i Arsimit (IA), Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK), divizionet dhe mekanizmat e tjerë mbështetës: Divizioni për Kurrikulë dhe Mbështetje të Mësimdhënësve; Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rritur (AAPARR) vazhdojnë të jenë mekanizmat kryesorë, të cilët kanë rol institucional në bazë të fushë veprimit të tyre që të përgatisin analiza, hulumtime dhe raporte të ndërlidhura me vlerësimin e sistemit. Kompetencat e këtyre mekanizmave për të vlerësuar sistemin dhe për të përdorur rezultatet e vlerësimit, janë të rregulluara me legjislacion primar (ligje) dhe me legjislacion sekondar (rregullore dhe akte nënligjore), dhe një pjesë e tyre janë përshkruar në kapitujt II, III, IV dhe V të këtij dokumenti.

**Divizioni për Sigurimin e Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim.** Divizioni kryen detyra profesionale, zhvillimore, organizative dhe teknike të lidhura me Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare në Arsimin parauniversitar. Është mekanizmi kryesor përgjegjës për kryerjen e

Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare të nxënësve në Arsimin parauniversitar të organizuara në Kosovë. <https://MASH.rks-gov.net/divizioni-per-standarde-monitorim-dhe-vleresim>

**Inspektorati për Arsim.** Me Ligjin e ri për Inspektoratin e Arsimit (2018), Inspektorati për Arsim merr një rol të veçantë në komponentin e inspektimit pedagogjik dhe bëhet organi kryesor ekzekutiv për sigurimin e cilësisë në arsim. Roli i ri i Inspektoratit për Arsim, i përcaktuar me Ligjin për Inspektoratin për Arsim (2018), paraqet një mundësi për inspektimin pedagogjik që sistemi do të duhej të përdoret për përgatitjen e raporteve vjetore dhe të raporteve tematike që lejojnë përdorime të shumta për vlerësimin e sistemit dhe marrjen e masave për ta përmirësuar dhe avancuar atë.

**Zyra për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Arsimit (SMIA).** Përgatit dhe publikon raporte të rregullta statistikore për sektorin e arsimit në të gjitha nivelet e ISCED-së. Publikimi vjetor i Statistikave të Arsimit qëllim kryesor ka informimin e institucioneve vendimmarrëse dhe publikun e gjerë me informacione statistikore në të gjitha nivelet e arsimit dhe treguesit arsimor. Raportet nga SMIA publikohen në <https://MASH.rks-gov.net/statistikat>.

**Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK).** IPK është institucion në varësi të MASH-it, i cili bën hulumtime, trajnime, këshillime, analiza, vlerësime, si dhe publikime profesionale në fusha të ndryshme të arsimit, me fokus në Arsimin parauniversitar. Publikimet shpërndahen në numër të caktuar të institucioneve arsimore në nivel qendror, lokal dhe në institucionet shkollore, që janë pjesë e kontributit në fushat e hulumtuara, mirëpo ato në vazhdimësi publikohen në faqen zyrtare të Institutit Pedagogjik <http://ipkMASH.rks-gov.net>

**Mekanizmat e tjerë mbështetës.** Në kuadër të MASH-it, ka Departamente, Divizione dhe njësi të tjera arsimore që udhëheqin zhvillimin e politikave arsimore, zhvillimin e kurrikulave dhe kontribuojnë në vlerësimin e sistemit arsimor në Kosovë. Mekanizmat e tjerë mbështetës që duhet të përmenden janë Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rritur (AAPARR), Këshilli Shtetëror për Arsimin Parauniversitar (KSHAP), Këshilli Shtetëror për Licencim (KSHL), Komisioni Qendror i Maturës Shtetërore (KQMSH), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AAK), etj.

Korniza parasheh që mekanizmat dhe kompetencat për të vlerësuar sistemin të plotësohen, rishikohen në varësi të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe fokusit në aspektet e vlerësimit të sistemit në periudha më afatgjata. DSCSVL, i cili është autoriteti i profesionalizuar dhe i autorizuar nga MASH për vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare, që bëhen me nxënës të niveleve të ndryshme të arsimit parauniversitar, duhet të koordinojë mekanizmat e sistemit në proceset dhe programet për vlerësimin e sistemit në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve.

## 6.2. Aspektet e vlerësimit të sistemit

Vlerësimi i nxënësve ka rol kryesor në vlerësimin e sistemit. Korniza parasheh që, krahas vlerësimit të nxënësve në teste kombëtare dhe ndërkombëtare, vlerësimi i sistemit arsimor të përqendrohet edhe në aspekte të tjera, si në: analizën e trendëve në arsim në raport me kornizën e treguesve arsimorë, (i. Qasja dhe pjesëmarrja; ii. Kushtet e mësimnxënies; iii. Efektiviteti i brendshëm; dhe iv. Burimet financiare) dhe në fushat tematike të sistemit, siç janë:

- zbatimi i kurrikulës (parimet, kompetencat dhe rezultatet e të nxënësve);
- vlerësimi i arritjeve të nxënësve;
- vlerësimi i performancës së mësimdhënësve në lidhje me standardet e mësimdhënies dhe zhvillimin e tyre profesional;
- vlerësimi i udhëheqjes në institucione arsimor/shkolla;

- vlerësimin e performancës së shkollës në lidhje me pritjet e përcaktuara nga MASH.

### **6.3. Ndërtimi i kapaciteteve për vlerësimin e sistemit**

Përvojat aktuale tregojnë se në vlerësimin e sistemit arsimor në Kosovë ka munguar një sinergji midis vlerësimit të nxënësve dhe vlerësimeve të tjera që ndodhin në sistem, përkatësisht ka munguar një sinergji e integritit të njohurive dhe të përvojave që vijnë nga burime të ndryshme dhe njerëz të ndryshëm për të vlerësuar sistemin dhe për të marrë veprime në formësimin e duhur të politikave dhe praktikave arsimore. Sinergjia në vlerësimin e sistemit duhet të bëhet parim pune dhe parim i udhëheqjes së këtij procesi, për të siguruar besim, i cili krijon të kuptuarit e përbashkët për kompetencat, përgjegjësitë dhe veprimet institucionale, për ngritjen e cilësisë së arsimit.

Ndërtimi i kapaciteteve për të udhëhequr procesin e vlerësimit të sistemit, për të gjeneruar të dhëna të besueshme, për të interpretuar dhe shfrytëzuar të dhëna, është nevojë dhe kërkesë për sektorin e arsimit në Kosovë, që duhet adresuar nga vendimmarrësit dhe politikë-bërësit në sektorin e arsimit.

Një sistem efektiv i vlerësimit kërkon ndërtim të kapaciteteve, ndarje të roleve dhe të përgjegjësive të mekanizmave ekzistues për rolin në vlerësimin e sistemit, për raportim të rregull dhe pjesëmarrje institucionale në proceset që lidhen me vlerësimin e sistemit, si dhe me marrjen e përgjegjësive për adresimin e problemeve të ngritura dhe rregullimin e gjendjes.

Ndërtimi i kapaciteteve për vlerësimin e sistemit në ndërlidhje me vlerësimin e nxënësve (vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare), duhet të bëhet në koordinim me DSCSVL/MASH.

Korniza parasheh disa masa që duhet ndërmarrë për ngritjen e kapaciteteve për vlerësimin e sistemit, të cilat duhet të shërbejnë si pika referimi për vlerësimin e sistemit:

- Hapja e debatit kombëtar për gjendjen në sistemin arsimor;
- Përcaktimi prioritetive ku duhet të fokusohet më shumë vlerësimi i sistemit;
- Qasja në një spektër të përshtatshëm njerëzish;
- Përcaktimi i mekanizmit kryesor për udhëheqjen e procesit, me detyra dhe mandat të qartë;
- Përcaktimi i grupeve e nëngrupeve punuese me një spektër të përshtatshëm njerëzish që kanë kapacitete profesionale dhe përvoja në fushën e vlerësimit;
- Analiza dhe përmbushja e nevojave teknike dhe organizative;
- Organizimi i trajnimeve profesionale për vlerësimin e sistemit;
- Sigurimi i qasjes në raportet dhe dokumentet kryesore;
- Ndërmarrja e vlerësimit të sistemit, një herë në 3-5 vite.

### **6.4. Procedurat dhe instrumentet për vlerësimin e sistemit**

Vlerësimi i sistemit është i lidhur me vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare të nxënësve, të cilat duhet të mbështeten edhe me analiza të treguesve arsimorë dhe analiza e vlerësime të kontekstit arsimor, politik, ekonomik, social e shoqëror.

Vlerësimet kombëtare të nxënësve duhet të reflektojnë përmbajtjen e kurrikulës, të jenë objektive, të paanshme dhe të japin rezultate të besueshme që të mbështesin sistemin, të identifikojnë fushat ku nevojiten shqyrtime të mëtejshme apo marrje të masave për adresimin e problemeve dhe rregullimin e gjendjes.

Procedurat dhe instrumentet e përdorura në vlerësimet kombëtare të nxënësve, janë procedura që zhvillohen nga DSCSVL, në varësi nga natyra dhe qëllimi i vlerësimit, si dhe nga nivelet e vlerësimeve kombëtare. Ato përfshijnë të gjithë hapat e menaxhimit të procesit të vlerësimit, duke filluar nga

përgatitja dhe planifikimi për vlerësim deri te raportimi për mbarëvajtjen e procesit dhe rezultatet e arritura.

Për çdo vlerësim kombëtar të nxënësve, sipas përshkrimeve në Kapitullin III, procedurat dhe instrumentet duhet të zhvillohen nga DSCSVL, në varësi nga natyra dhe qëllimi i vlerësimit, si dhe nga nivelet e vlerësimeve kombëtare. Korniza parasheh që në vlerësimet kombëtare, procedurat dhe instrumentet për të vlerësuar sistemin duhet të përfshijnë:

- të gjithë hapat e menaxhimit të procesit të vlerësimit;
- udhëzimet për gjithë procesin e vlerësimit;
- informimin e publikut;
- hartimin e raporteve teknike dhe publikimin e tyre;
- përdorimin e rezultateve të vlerësimit për hartimin e politikave arsimore.

Gjithashtu, Korniza parasheh që për pjesëmarrje në vlerësimet ndërkombëtare të nxënësve, me qëllim për të vlerësuar sistemin në fusha të caktuara, procedurat që duhet të udhëheqin këtë proces duhet të jenë si në vijim:

- analiza e situatës dhe arsyeshmëria për pjesëmarrje në vlerësim-in/et ndërkombëtare;
- plani operacional për pjesëmarrje në vlerësim-in/et ndërkombëtare, duke filluar nga informimi deri në përfundim të ciklit të vlerësimit, përfshirë edhe kapacitetet e nevojshme për udhëheqje, koordinim dhe raportim;
- planifikimi i buxhetit të nevojshëm për pjesëmarrje në vlerësime;
- shqyrtimi i analizës së situatës dhe i planeve orientuese në mekanizmat vendimmarrës dhe marrja e vendimit;
- ndjekja e të gjitha procedurave standarde në vlerësimet ndërkombëtare, në rastet e miratimit të pjesëmarrjes, me qëllim të sigurimit të plotë të cilësisë së vlerësimit;
- përgatitja e raportit teknik për procesin dhe rezultatet e vlerësimit;
- publikimi dhe diskutimi i rezultateve, analiza të thelluara për shkaqet dhe mundësitë e adresimit të problemeve të evidentuara;
- përdorimi i rezultateve të vlerësimit për hartimin e politikave arsimore.

#### **6.5. Përdorimi i rezultateve të vlerësimit për hartimin e politikave**

Korniza ndihmon në formulimin e drejtimeve të reja të veprimit pas vitit 2020. Drejtimit e reja të veprimeve mund të zhvillohen duke vlerësuar në mënyrë kritike cilësinë e të gjitha formave të vlerësimeve, që të krijojmë një qasje ndaj vlerësimit dhe përmirësimit të praktikave të vlerësimit, duke përdorur kriteret e përmendura në Kapitullin II. Vlerësimet e tilla do të ndihmojnë për të realizuar prioritetet e drejtimeve të veprimit, në qoftë se një vlerësimi i mungon njëri nga ato kriteret.

Pas realizimit të planit të zbatimit të vlerësimeve, fokusi duhet të zhvendoset në përdorimin e rezultateve të vlerësimit për hartimin e politikave. Kjo kërkon arritjen e konsensusit në nivel kombëtar për përmirësimin e cilësisë së arsimit në përgjithësi. Këtë e definojnë Korniza si prioritet për të filluar përdorimin e rezultateve të vlerësimit për hartimin e politikave me konsensus dhe interes kombëtar.

Pastaj, Korniza parasheh që, pas çdo vlerësimi kombëtar apo ndërkombëtar, departamentet dhe mekanizmat e tjerë, në varësi të MASH-it, duhet të ulen së bashku dhe të zhvillojnë një proces të asaj se çfarë ndodh pas vlerësimeve dhe analizave, si të përdoren rezultatet për hartimin e politikave, çfarë lidhje do të bëhen - me aftësimin e mësuesve - para shërbimit dhe gjatë shërbimit, kurrikula, mekanizmat për sigurimin e cilësisë, etj.



Siç është përshkruar në Kapitullin III të këtij dokumenti, vlerësimi i sistemit duhet të përdoret në një mënyrë formative, duke ndihmuar në këtë mënyrë vendin të përmirësojë sistemin arsimor. Rezultati nga Vlerësimi i jashtëm, nga Vlerësimet ndërkombëtare, janë burim i informatave që mund të ndihmojë për të gjetur çfarë funksionon dhe çfarë jo. Rezultati duhet të përdoret për të bërë pyetjet: “Pse i kemi këto rezultate?” Shpjegimi duhet të bëhet me kujdes dhe duhet të testohen hipotezat e parashtruara të shkaqeve të ndryshimeve.

Përdorimi i rezultateve të vlerësimit për hartimin e politikave do të përqendrohet në:

- Përcaktimin e prioriteteve;
- Ndërmarrjen e veprimeve për hartimin e politikave prioritare;
- Drejtimin e buxhetit, të burimeve e të kapaciteteve që të përfitojnë të gjithë nxënësit; dhe
- Paraqitjen e rekomandimeve që mbështesin proceset e tjera për të vlerësuar sistemin.

Ndërtimi i kapaciteteve për të udhëhequr procesin e përdorimit të rezultateve të vlerësimit për hartimin e politikave dhe për të hartuar politika arsimore që gjejnë zbatim në praktikën e arsimit kosovar, është nevojë dhe kërkesë që buron nga ky dokument, që duhet adresuar nga vendimmarrësit dhe politikëbërësit në sektorin e arsimit.

## **6.6. Dokumentet relevante**

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-068 (2008), Prishtinë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës  
[http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L068\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L068_al.pdf)
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 04/L-032 (2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës  
<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20arsimin%20parauniversitar.pdf>
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2018): Ligji nr. 06 / L-046 Për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=1774>
4. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë. IPK, Prishtinë.  
<http://ipkMASH.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-se-shkolles/>
5. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (04/2017). Udhëzimi Administrativ nr. 04/2017: Vlerësimi i Performancës në Institucionet e Arsimore. Prishtinë.  
<http://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/08/4-2017-ua-vleresimin-e-performances-se-institucioneve-arsimore-ne-arsimin-parauniversitar-rotated.pdf>
6. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2015). Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020. Prishtinë.  
<http://MASH.rks-gov.net/uploads/2016/12/qa-strategy-final-shqip.pdf>
7. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016c). Udhëzimi Administrativ nr. 24/2016: Sigurimi i Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Prishtinë.  
<http://MASH.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf180.pdf>
8. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). PISA – Raport për arritjet e nxënësve të Kosovës në PISA 2015. Divizioni për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim.
9. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2016). Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020. f. 5.  
<https://MASH.rks-gov.net/uploads/2016/12/qa-strategy-final-shqip.pdf>

10. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), 2018. Raport vjetor i vlerësimit i planit strategjik të arsimit të Kosovës 2017-2021. Shkurt 2018.  
[https://www.researchgate.net/profile/Armend\\_Muja/publication/325895588\\_Raport\\_Vleresimi\\_i\\_i\\_Sistemit\\_Arsimor\\_ne\\_Kosove\\_2017/links/5b2b66064585150c6344b25a/Raport-Vleresimi-i-Sistemit-Arsimor-ne-Kosove-2017.pdf](https://www.researchgate.net/profile/Armend_Muja/publication/325895588_Raport_Vleresimi_i_i_Sistemit_Arsimor_ne_Kosove_2017/links/5b2b66064585150c6344b25a/Raport-Vleresimi-i-Sistemit-Arsimor-ne-Kosove-2017.pdf)
11. Peffers, J., Reid, E., Stylianidou, dr. F., Walsh, dr. P., & Young, prof. Michael (2005). Planprogramet kombëtare në Kosovë – Vlerësim i hapave të parë. f. 14. Instituti i Edukimit, Universiteti i Londrës.
12. Qehaja, L. & Aliu, J., (2018). Ndikimi i cilësisë së mësimdhënësve dhe burimeve shkollore në rezultatet e nxënësve kosovarë: Gjetjet nga rezultatet e testit PISA të vitit 2015. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN. (faqe 11).  
[http://kec-ks.org/ëp-content/uploads/2018/10/PISA-2015-Results\\_ALB-1.pdf](http://kec-ks.org/ëp-content/uploads/2018/10/PISA-2015-Results_ALB-1.pdf)
13. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë Korniza e Treguesve të Arsimit në Kosovë (tetor, 2017)  
[https://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/12/korniza-e-treguesve\\_2.pdf](https://MASH.rks-gov.net/uploads/2017/12/korniza-e-treguesve_2.pdf)

